



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

NDIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA NË GDP: RASTI I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

KANDIDATE:

Illirjana Bexheti

MENTOR:

Assoc.Prof.Dr Hyrije Abazi-Alili

Tetovë, Nëntor 2019

PËRMBAJTJA :

HYRJE	7
1.0 KAPITULLI I.....	13
1.1 Lënda e hulumtimit.....	13
1.2 Qëllimet e hulumtimit.....	14
1.3 RËNDËSIA E PUNIMIT.....	15
1.4 STRUKTURA E PUNIMIT.....	16
2.0 KAPITULLI II	18
ASPEKTET TEORIKE DHE RISHIKIMI I LITERATURËS MBI INVESTIMET E HUAJA.....	18
2.1 Koncepti i Investimeve të Huaja	18
2.1.1 Llojet e Investimeve të Huaja.....	20
2.2 Rishikimi i literaturës së IH-ve dhe GDP-së	23
2.3 Politikat dhe format tërheqëse për Investitorët e Huaj	25
2.3.1 Zonat Ekonomike.....	28
2.3.2 Zonat Ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	30
2.4 Avantazhet dhe disavantazhet që shoqërojnë IH-të	35
Kapitulli III	37
Investimet të Huaja në Republikën e.....	37

Maqedonisë së Veriut.....	37
3.1 Zhvillimi Ekonomik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	37
3.2 Trendet e IH-ve në Maqedoninë e Veriut	39
3.3 Përbërja sektoriale e IH-ve në RMV	43
3.4 Analizë grafike e ndikimit të investimeve të huaja në zhvillimin ekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	45
4.0 KAPITULLI IV	46
Metodologjia e kërkimit	46
4.1 Metodologjia	46
4.1.1 Ekuacioni regresiv midis investimeve dhe PBB	47
4.1.2 Analiza e regresionit të testit të shkakësisë - Granger.....	48
4.1.3 Koeficienti i determinacionit, aleancës dhe korelacionit midis investimeve dhe GDP për vitet (2009-2019).....	56
4.1.4 Devijimi standard i investimeve dhe GDP në periudhën 2009-2019.....	58
4.2 Hipotezat.....	59
5.0 Përfundimi.....	60
Referencat:.....	63

Abstrakt

Investimet e Huaja (IH) paraqiten si element kyç për zhvillimin e ekonomisë së një vendi, ato paraqiten si urë lidhëse afatgjate që lejojnë ekonomitë e vendeve të ndryshme të promovojnë produktet e tyre në tregjet ndërkombëtare. Norma e lartë e zhvillimit të globalizimit ka bërë të mundur që IH-të të paraqesin një element të rëndësishëm në procesin e integrimit global ekonomik, duke krijuar efekt si në vendin pritës ashtu edhe në vendet e origjinës.

Duhet patur në konsideratë se IH-të kanë ndikim të dyanshëm në ekonominë e vendit pritës, që mund të ketë ndikim pozitiv dhe ndikim negativ, pasi që IH-të mund të trondisin një industri ekzistuese, përderisa IH me vete bartin edhe teknologjitë e shkallës më të lartë dhe produktivitet më cilësor. Mirëpo, në të shumtën e rasteve, posaçërisht në vendet në zhvillim, IH-të mund të forcojnë ekonomitë lokale duke krijuar vende të reja të punës, duke vetëdijësuar forcën punëtore të *vendit pritës për mënyrat më cilësore të produktivitetit etj.

Qëllimi i këtij studimi është të/ analizojmë ndikimin e IH-ve në GDP në vendet në zhvillim, konkretisht rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut .

Sa i takon analizës së këtij studimit të gjitha të dhënat janë marrë nga Banka Botërore, Banka Popullore e RMV, FMN dhe ESHS.

Nëse ka mungesë të kursimit vendas për investime, siç është rasti me RM, zgjidhja kërkohet në huamarrje nga shtete të tjera që kanë tepriçë të kursimit, gjatë së cilës duhet pasur kujdes që shteti të mos mbingarkohet me borxh. Sipas vlerësimeve të Bankës Popullore (NBRM), Republika e Maqedonisë së Veriut bie në radhët e shteteve mesatarisht të ngarkuara me borxhe. Duke pasur parasysh këtë, rekomandohet, në vend se të merren kredi të huaja, në investimet e vendeve të huaja të arrihet përmes investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe investimeve të përbashkëta mes partnerëve të huaj dhe të vendit.

Апстракт

Странските директни инвестиции (СДИ) се појавија како клучен елемент за економскиот развој на една земја, тие се претставени како долгорочен мост кој им овозможи на економиите од различни земји да ги промовираат своите производи на меѓународните пазари. Висока норма на развој на глобализацијата овозможуваат странските директни инвестиции (СДИ) да бидат важен елемент во процесот на глобалната економска интеграција, создавајќи ефект и во земјата домаќин и во земјите со потекло. Треба да се има во предвид дека странските директни инвестиции (СДИ) имаат влијание и пристрасти во економијата на земјата домаќин, која може да има позитивно и негативно влијание, бидејќи СДИ може да шокират постоечка индустрија, за време на СДИ се носат технологии на највисоко ниво и квалитативен продуктивитет. Истата ја имаше, во многу случаи, особено во странските директни инвестиции во земјите во развој може да се зајакнат локалните економии преку создавање на нови работни места, реализирајќи ја со свесност работната сила на земјата домаќин за начинот на продуктивноста на квалитетот итн. Целта на оваа студија (труд) е да се анализира влијанието на странските директни инвестиции (СДИ) врз БДП во земјите во развој во случајот на Република Северна Македонија. Што се однесува до анализата на овој студиски труд сите податоци се собрани од Светската Банка, ММФ и ЕСХС.

Доколку недостигаат локални заштеди за инвестирање, како што е случајот со РСМ, решението се бара во задолжување кај други држави кои имаат вишок на заштеди, при што мора да се внимава државата да не биде преоптоварена со долгови. Според оценките на Народната банка (НБ), Република Северна Македонија спаѓа меѓу државите со умерени долгови.

Имајќи го ова предвид, се препорачува наместо преземање странски заеми, инвестициите на странските земји да се остваруваат преку директни странски инвестиции и заеднички инвестиции меѓу странски и домашни партнери.

Abstract

Foreign Direct Investment (FDI) is a key element in the development of a country's economy, as long-term bonds that allow economies and countries to promote their products in international markets. The high growth rate of Globalization has made it possible for Foreign Direct Investment (FDI) to be an important element in the process of global economic integration, creating the effect both in the host country and in the countries of origin.

It should be noted that Foreign Direct Investment (FDI) has two impacts on the economy of the host country, which may have a positive impact and negative impact as FDI may shake an existing industry, while FDI with it carry even the highest-quality technology and quality products, but in most cases, especially in developing countries, FDI can strengthen the local economy by creating new jobs, while acknowledging the host country's workforce for more productive productivity.

The purpose of this study is to analyze the impact of Foreign Direct Investment (FDI) on GDP in developing countries in the case of the Republic of Macedonia. Data analysis has been collected by the World Bank, the IMF, and ESHS.

If there is a lack of local savings for investment, as is the case with RM, the solution is sought in borrowing from other states that have a surplus of savings, during which care must be taken that the state is not overloaded with debt. According to the evaluations of the National Bank (NBRM), the Republic of North Macedonia falls among the states with moderate debts. Bearing this in mind, it is recommended, instead of taking foreign loans, to achieve the investments of foreign countries through direct foreign investments and joint investments between foreign and domestic partners.

HYRJE

Investimet e Huaja (IH) paraqiten si element kyç për zhvillimin e ekonomisë së një vendi, ato paraqiten si urë lidhëse afatgjate që lejojnë ekonomitë e vendeve të ndryshme të promovojnë produktet e tyre në tregjet ndërkombëtare. Norma e lartë e zhvillimit të globalizimit ka bërë të mundur që IH-të të paraqesin një element të rëndësishëm në procesin e integritit global ekonomik, duke krijuar efekt si në vendin pritës ashtu edhe në vendet e origjinës. Duhet patur në konsideratë se IH-të kanë ndikim të dyanshëm në ekonominë e vendit pritës, që mund të ketë ndikim pozitiv dhe ndikim negativ, pasi që IH-të mund të trondisin një industri ekzistuese, përderisa IH me vete bartin edhe teknologjitë e shkallës më të lartë dhe produktivitet më cilësor. Mirëpo, në të shumtën e rasteve, posaçërisht në vendet në zhvillim, IH-të mund të forcojnë ekonomitë lokale duke krijuar vende të reja të punës, duke vetëdijësuar forcën punëtore të vendit pritës për mënyrat më cilësore të produktivitetit etj.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojmë ndikimin e IH-ve në GDP në vendet në zhvillim, konkretisht rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut .

Sa i takon analizës së këtij studimit të gjitha të dhënat janë marrë nga Banka Botërore, Banka Popullore e RMV, FMN dhe ESHS.

Nëse analizojmë ndonjëherë tregtinë ekonomike në një periudhë të caktuar kohore do të vërejmë ritjet dhe rëniet e tij, përkatësisht lëvizjen për sipër dhe për poshtë të indikatorëve të prodhimit shoqëror në atë ekonomi të tregut. Për shkak se flasim për IH, mund të shtojmë se janë indikatorët më sintetik në makroekonominë, kjo do të thotë se lëvizja e saj në vite të caktuara është shoqëruar me rënie evidente, përkatësisht me rritjen e shpejtë në vite tjera. Prandaj themi se zhvillimi është ciklik.

Duke i mësuar marrëdhëniet ndërkombëtare, përpos importit dhe eksportit të të mirave dhe shërbimeve, lëvizja e kapitalit ndërkombëtar është veti e rëndësishme e tregtisë së jashtme. Dy forma të rëndësishme të eksportit të kapitalit janë: Investimet e Huaja dhe Portofol investime. Të gjitha shtetet të pasura dhe të varfra, të mëdha dhe të vogla i preferojnë investitorët për shkak se ata sjellin rritje ekonomike, punësime, rritjen e standardit jetësor, qytetarë të kënaqur dhe rejting më të madh për politikanët. Çdo shtet tenton të ofrojë diçka të veçantë, diçka më ndryshe, diçka të cilën shtetet tjera nuk e kanë. Ndërsa qëllimi i investitorëve është realizimi i përfitimit. Prandaj, shkak i vetëm i cili mund t'i sfidojë të investojnë paratë e tyre në shtet të huaj në fakt është përfitimi. Gjatë kësaj përfitimi vendoset në kombinim me rrezikun. Normalisht, rreziku më i madh kërkon shkallë më të lartë të përfitimit, dhe e kundërta, gjatë rrezikut më të vogël investitori do të pranojë edhe shkallë më të vogël të përfitimit.

Investimet e Huaja (IH) realizohen nga ana e kompanive trans nacionale nëpërmjet hapjes së filialeve të tyre në shtete të huaja, me anë të qiramarrjes të pakos kontrolluese për aksionet e ndërmarrjes permanente ose me hapjen e një ndërmarrjeje të re. IH kryhen nga firma të mëdha në relacion shtete të zhvilluara - shtet i zhvilluar, por edhe në shtetet në tranzicion dhe në zhvillim. Kapitali i huaj nga lloji i investimeve të drejtpërdrejta e plotëson kursimin të pamjaftueshëm vendas, mundëson aktivitet investues më intensiv dhe e nxit zhvillimin ekonomik. Ekonomitë nacionale në tranzicion (këtu bën pjesë edhe RMV-ja) objektivisht janë të udhëzuar në shfrytëzimin e kapitalit të huaj dhe ai ka rol jashtëzakonisht të rëndësishëm, duke pasur parasysh nevojat për dalje nga gjendja ekonomike e pavolitshme dhe zbatimin e reformave strukturore. Nëpërmjet Investimeve të Huaja mbulohet nyja ndërmjet shkallës së bruto - investimeve dhe akumulimit vendas, me çka aftësohet ekonomia për zhvillim të ardhshëm.

Objekti i punimit është analiza e ndikimit të Investimeve të Huaja në GDP e RMV, hende kun e teknologjisë, rolin e kapaciteteve absorbuese lokale në kapjen e përparimit modern,

konkretisht ndikimin e përhapjes së teknologjisë në produktivitetin e firmave lokale. Gjithashtu, analiza e faktorëve kyç që vendi pritës duhet t'i sigurojë për tërheqjen e Investimeve të Huaja , pa mos anashkaluar analizën e pengesave që mund të hasen te Investitorët e Huaj gjatë investimit në RMV dhe të kundërtën, analizën e përfitimeve të Investitorëve të Huaj gjatë investimit në RMV.

Pikë tjetër interesante e këtij punimi shkencor është regresi në shtetin tonë, në RMV. Sipas të dhënave statistikore rritja e investimeve dhe financimit, duke përfshirë intensifikimin e asistencës para-aderuese në përputhje me dispozitat ligjore, rregullat dhe procedurat në fuqi dhe një bashkëpunim më të ngushtë me institucionet relevante financiare ndërkombëtare, me qëllim që të nxiten investimet dhe mbështetja; shfrytëzimi i fondeve të huaja duhet të krijojë një avantazh të fuqishëm evropian dhe një ekonomi të fuqishme lokale me projektet që zbatohen, nga ana Investitorëve të Huaj dhe bizneseve lokale,, duke përfshirë edhe kornizën përkatëse ligjore. Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të merr masa korrigjuese vendimtare dhe proporcionale, në rastet e çfarëdo lloji ngecjeje serioze ose të vazhdueshme, ose regres në zbatimin e reformave financiare si dhe obligimet ndërkombëtare. Investimet janë kategori ekonomike ku kursimi i popullatës dhe firmave, gjegjësisht mjetet pagesore të përgjithshme të lira i shndërron në të mira kapitale materiale dhe jo materiale.

Investimet, gjegjësisht mjetet investuese shërbejnë për rinovimin dhe për zgjerimin e bazës prodhuese të shoqërisë, ndërsa rrjedhin nga amortizimi (kompensimi për makinat-pajisjet eshpenzuara) dhe nga kursimi (akumulimi), si pjesë e vlerës së porsakrijuar. Rëndësi e veçantë e investimeve, në fakt është rinovimi, dhe para së gjithash në zgjerimin e aftësisë prodhuese të shoqërisë. Investimet i lidhin të gjithë faktorët e tjerë të zhvillimit, për çka, gjithashtu, flasim (fuqia punëtore, resurset natyrore, përparimi tekniko-teknologjik etj), mundësojnë nivel të bashkëveprimit në realizimin e zhvillimit ekonomik. Ashtu që, me investimet, aktivizohen resurset natyrore që deri atëherë ende nuk ishin të shfrytëzuara, gjatë së cilës hapen vende të reja të punës dhe punësohen popullata e papunësuar që është e aftë

për punë, e cila fillon të mirëmbahet dhe të krijohet prodhimi i re për kënaqjen jo vetëm të nevojave personale por edhe të nevojave publike. Me investimet kryhet dhe modernizimi i kapaciteteve ekzistuese dhe objekteve, pranohen teknika dhe teknologji të reja dhe njohuri të reja, ndërsa ajo sjell rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit. Tani të punësuarit prodhojnë më tepër dhe më me cilësi, por edhe me shpenzime më të vogla të materialeve, lëndëve të para, energjisë dhe fuqisë punëtore, si dhe me më shumë njohuri. Duke pasur parasysh është e kuptueshme pse sot investimet janë në hulumtimet shkencore, në teknikën dhe teknologjinë e re, në njohuri të reja dhe në kuadro profesionale të reja që konsiderohen si investime më të rëndësishme, me efekt më të madh që ndikon afatgjatë.

Këto mjete për investime sigurohen nga pjesa e të ardhurave të amvisërive që shkon në kursim dhe neto-tepricën, gjegjësisht kursim i përbashkët i firmave - si kursim i përbashkët për investime. Çështje qendrore e politikës investuese është si të zmadhohen këto kursime të amvisëritë dhe të firmat, që pastaj të transformohen në investime.

Nëse ka mungesë të kursimit vendas për investime, siç është rasti me RM, zgjidhja kërkohet në huamarrje nga shtete të tjera që kanë tepricë të kursimit, gjatë së cilës duhet pasur kujdes që shteti të mos mbingarkohet me borxh. Sipas vlerësimeve të Bankës Popullore (BP), Republika e Maqedonisë së Veriut bie në radhët e shteteve mesatarisht të ngarkuara me borxhe. Duke pasur parasysh këtë, rekomandohet, në vend se të merren kredi të huaja, në investimet e vendeve të huaja të arrihet përmes investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe investimeve të përbashkëta me partnerëve të huaj dhe të vendit.

Në gravikonet, tabelat dhe figurat e këtij punimi, rezulton edhe rritja dhe ulja e Investimeve të Huaja nga shtete të ndryshme evropiane e më gjerë.

Lista e shkurtimeve dhe fjalorit

IH - Investimet e Huaja

BB-Banka Botërore

BQ - Banka Qendrore

BE-Bashkimi Evropian

FMN-Fondi Monetar Ndërkombëtar

ANI-Agjencia e Nxitjes së Investimeve

BERZH- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

OECD-Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

IPA -Investment Promotion Agency

BIT – Bilateral Investment Treaties

WTO – World Trade Organization

R&D – Research and Development

TNC – Traditional Corporates

PPP- Partneritete publike-private

Lista e tabelave :

Tabela 1: Politikat dhe format tërheqëse për Investitorët e Huaj

Tabela 2: Përparësitë krahasuese

Tabela 3. TOP 10 Investimet më të mëdhaja në RMV (2001-2008)

1.0 KAPITULLI I

1.1 Lënda e hulumtimit

Sot bota është e lidhur më shumë se kurrë. Zhvillimi i teknologjisë dhe përparimi i bashkëpunimit ndërkombëtar ka bërë të mundur që tregu ekonomik në çdo skaj të botës të jetë i imagjinueshëm dhe në të njëjtën kohë i realizueshëm për çdo pjesëmarrës në treg.

Ndryshimi teknologjisë, konkurrenca globale dhe liberalizimi i tregjeve bëjnë të mundur që Investimet e Huaja të jenë sa më aktive dhe gjithmonë në rritje të cilat luajnë një rol kyç në procesin e integritit global ekonomik. IH paraqiten si fenomene të cilat nuk mund të maten nga shpejtësia e zhvillimit të hovshëm dhe ndikimi i tyre në vendin ku operojnë, dhe të tillë konsiderohen si fenomene relativisht të reja.

Nëpërmjet Investimeve të Huaja, vendet sigurojnë kapital të nevojshëm, teknologji moderne, qasje në tregjet ndërkombëtare, rritje dhe zhvillim në produktivitet, zgjerimin e konkurrencës, krijimin e menaxhimit modern si dhe rritjen financiare e sociale të popullatës së një vendi duke krijuar vende të reja pune.

Duke ndjekur rritjen e atraksionit të Investimeve të Huaja kuptojmë se një shtet duhet të ketë politikë të mirë të konceptuar makroekonomike për të tërhequr Investimet e Huaja dhe për t'i bërë pjesë të ekonomisë së tyre, për krijimin e një atmosfere përparuese politike dhe ekonomike në vend.

Në këtë punim do të analizohet procesi, metodat, zhvillimi, tërheqja e Investitorëve të Huaj ku vëmendje më të madhe do të ketë ndikimi i këtyre investimeve në PBB-në e RMV-së. Për shkak të jo stabilitetit politik dhe ekonomik në RMV ka pasur shkallë të ulët të IH, që nga dekada e fundit, domethënë gjatë vitit 2000 kemi lëvizshmëri të dukshme të këtij

fenomeni në RMV dhe kjo është një ndër arsyt kryesore të analizës së këtij punimi shkencor.

1.2 Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të identifikojmë lidhjen, raportin dhe ndikimin e Investimeve të Huaja në GDP e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke analizuar aspektet teorike dhe praktike dhe për të ardhur në përfundim se cili është efekti që rezulton, qoftë pozitiv apo negativ dhe si afekton ky efekt popullatën e vendit .

Në teori ekziston teza se Investimet e Huaja kanë ndikim pozitiv posaçërisht në vendet në zhvillim, siç është RMV pasi që Investimet e Huaja kanë një rol të rëndësishëm në krijimin e mundësive të reja të punës, duke reduktuar kështu problemin e papunësisë, që është një fenomen i përhapur në vendet në zhvillim.

Më konkretisht pyetjet kërkimore të këtij studimi do të jenë:

- -Si ndikojnë Investimet e Huaja në zhvillimin ekonomik dhe në normën e papunësisë?
- -Cilat politika dhe matje janë treguar si më të suksesshme në tërheqjen e Investitorëve të Huaj që do të rezulton në rritje më të shpejtë të zhvillimit ekonomik në RMV?
- Çfarë relacioni krijohet në mes Investimeve të Huaja dhe rritjes ekonomike së RMV-së?

Të gjitha këto fakte teorike pozitive, por qofshin edhe negative, për të gjitha pyetjet e lartëpërmendura, ekziston mundësia për të vërtetuar dhe analizuar detajisht ndikimin e Investimeve të Huaja në RMV ku si përfundim do të kemi informacione të plota rreth kësaj lidhshmërie të këtyre dy fenomeneve që momentalisht janë prezente në mbarë tregun global.

1.3 RËNDËSIA E PUNIMIT

Në dekadën e fundit Investimet e Huaja dukshëm kanë ndikuar në ekonominë e vendeve në tranzicion siç është rasti me RMV, ku paraqiten si burim i rëndësishëm i kapitalit në vend duke pasur ndikim të rëndësishëm edhe në rritjen ekonomike.

Në shumë studime të deritashme është vërtetuar se IH kanë ndikim pozitiv në shtetë pritëse të cilat zakonisht janë vende në zhvillim dhe nga ky fakt, të njëjtat këto vende janë në gadishmëri për të përpiluar paketa të taksave speciale për të tërhequr sa më shumë investime. Objekti i punimit është analiza e ndikimit të Investimeve të Huaja në GDP e RMV, hende kun e teknologjisë, rolin e kapaciteteve absorbuese lokale në kapjen e përparimit modern, konkretisht ndikimin e përhapjes së teknologjisë në produktivitetin e firmave lokale. Gjithashtu, analiza e faktorëve kyç që vendi pritës duhet t'i sigurojë për tërheqjen e Investimeve të Huaja , pa mos anashkaluar analizën e pengesave që mund të hasen Investitorët e Huaj gjatë investimit në RMV dhe të kundërtën, analizën e përfitimeve të Investitorëve të Huaj gjatë investimit në RMV .

Të analizojmë në mënyrë detale pjesëmarrjen dhe faktorët kyç që tërheqin Investitorët e Huaj për të pasur ndikim në GDP e RMV dhe në cilët nga faktorët e mëposhtëm RMV, si shtet, u kushton më shumë vëmendje:

- Qasja në punë të kualifikuar me paga më të ulëta;
- Qasja në treg të madh lokal;
- Qasja në burime natyrore;
- Taksa të ulëta dhe subvencione të ndryshme;
- Afërsia me furnizuesit;
- Aglomimi;
- Qasja në financim.

Duke pasur parasysh në fokus zhvillimin e vendeve në tranzicion e shikoj të arsyeshme të jap një punim special për këtë fenomen siç janë Investimet e Huaja që ndikojnë aq shumë në zhvillim dhe përparimin e një vendi në shumë caqe të rëndësishme siç kemi përmendur më lart.

1.4 STRUKTURA E PUNIMIT

Ky punim do të shqyrtohet në mënyrë detale në pesë kapitujt e mëposhtëm. Struktura e punimit vijon më poshtë.

Në kapitullin e parë është trajtuar lënda dhe qëllimet e studimit. Kam bërë një përshkrim të rëndësisë dhe qëllimit të kësaj teme kaq të prekshme në vendet në tranzicion .

Në kapitullin e dytë kam bërë një rishikim të literaturës në lidhje me Investimet e Huaja (IH) definicione rreth IH-ve, rëndësinë e tyre, llojet e IH , ndikimin e tyre në vendin pritës dhe atë të origjinës në GDP dhe ndikimin e tyre në faktorë të tjerë ekonomik, mënyrat dhe politikat të cilat janë pikat kryesore të tërheqjes së Investimeve të Huaja (IH) në vendet në tranzicion.

Në kapitullin e tretë pjesa më konkrete e punimit ku është analizuar pjesa teorike e të dhënave për zhvillimin ekonomik të RMV-së , është analizuar pjesëmarrja e investimeve në RMV për një periudhë kohore , trendet e Investimeve të Huaja, shpërndarja e IH-ve në bazë të sektorit ku ato funksionojnë dhe një analizë grafike e ndikimit të IH-ve në GDP e RMV-së Kapitulli i katërt: -Në këtë kapitull përshkruhen metoda të përdorura gjatë kryerjes së këtij punimi, mbledhjen e të dhënave nga Banka Qëndrore, ekuacioni regresiv midis investimeve dhe PBB, koeficientin e determinacionit, aleancës dhe korelacionit midis investimeve dhe GDP për periudh të caktuar , si dhe devijimi standard të investimeve dhe GDP për periudh të caktuar.

Kapitulli i pestë:- **PËRFUNDIMI:** paraqet kapitullin e fundit ku jepet një përmbledhje e tezës në lidhje me konkludimet, rekomandimet dhe sugjerimet e mundshme.

2.0 KAPITULLI II

ASPEKTET TEORIKE DHE RISHIKIMI I LITERATURËS MBI INVESTIMET E HUAJA

Në pjesën e parë të këtij punimi do të shqyrtohen paraqitjet e përgjithshme të Investimeve të Huaja. Në këtë mënyrë, do të japim një këndvështrim të përgjithshëm mbi Investimet e Huaja, duke analizuar definicionet për Investimet e Huaja nga burime të ndryshme, dhe duke vijuar më pas në analizën e ndarjes së tyre bazuar në rishikimin e literaturës .

2.1 Koncepti i Investimeve të Huaja

Tregjet financiare kanë evoluar në një kornizë më të integruar globalisht si rezultat i rritjes së liberalizimit të kontrolleve të këmbimit dhe qasjes në treg. Ky integrim i përshpejtuar nga rritja e konkurrencës midis pjesëmarrësve të tregut, ka çuar në futjen e instrumenteve të reja financiare me qasje të gjerë në treg dhe transaksion më të ulët në kosto, duke tërhequr investitorë të vendeve të ndryshme. Zgjerimi i flukseve financiare ndërkufitare është përshpejtuar më tej nga risitë teknologjike në komunikimin dhe përpunimin e të dhënave (OECD, 2008).¹

Koncepti i Investimeve të Huaja ka qenë kontekst që nga dekada e zhvillimit të OKB-së të viteve 1960. Gjithmonë kanë ekzistuar pikëpamje në favor të IH-ve dhe kundër saj.

¹ <https://www.oecd.org/daf/inv/investmentstatisticsandanalysis/40193734.pdf>

Pikëpamjet në favor të IH mbështesin idenë se IH-të çojnë në: (I) rritjen ekonomike, (II) rritjen e produktivitetit, dhe (III) rritjen e standardit të një vendi pritës. Ndërsa pikëpamjet negative apo kundër IHD-ve mbështesin idenë se IHD-të: (I)shkatërrojnë aftësinë/kompetencën lokale, dhe (II) shkatërrojnë konkurrencën lokale.²

Në pjesën teorike të Investimeve të Huaja ekzistojnë një numër i larmishëm definicionesh, për shkak të vet natyrës dhe karakterit kompleks të tyre. Duke filluar nga një përkufizim klasik i investimeve të drejtpërdrejta të huaja që është se: *“IH-të konsiderohen si lëvizje e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve përtej kufirit shtetëror ku qëllimi i këtij veprimi është maksimizimi i fitimit”*. Një përkufizim më konkret është edhe ai se: *“IH-të do të konsiderohet një kompani e një vendi të caktuar që bën një investim fizik duke ndërtuar një firmë apo ndërmarrje industriale të çfarëdoshme në një vend tjetër (Rugman & Hodgetts, 1995).”*

Fondi Monetar Ndërkombetar (FMN) dhe Banka Qendrore (BQ) për Investimet e Huaja (IH)përfaqëson përkufizimin e tyre si investime vlera e te cilit në firmën e blerë është mbi 10%. Investimet të Huaja përveç kapitalit të vet në kompani investon edhe teknologjinë, njohuritë, metodat, përvojën e shumë elemente të tjera kyçe që nxisin investitorin që ai të jetë i interesuar për udhëheqjen, kontrollin dhe menaxhimin e ndërmarrjes ku investon, që rrjedh se investitori tek IH ka kontroll efektiv mbi investimin e realizuar

Investimet e Huaja janë një urë lidhëse për krijimin e lidhshmërive të drejtpërdrejta , të qëndrueshme dhe afatgjate midis ekonomive të vendeve të ndryshme . Në mjedisin e duhur politik, IH mund të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e ndërmarrjeve vendore

²<https://www.odi.org/publications/594-foreign-direct-investment-development-historical-perspective>

dhe gjithashtu mund të ndihmojë në përmirësimin e tyre. Në veçanti, IH inkurajojnë transferimin e teknologjisë dhe njohuritë midis ekonomive të ndryshme. IH gjithashtu ofrojnë një mundësi për ekonominë pritëse për të promovuar produktet e saj më gjerësisht në tregjet ndërkombëtare.

IH-të janë çelësi kyç i integritit ekonomik ndërkombëtar. Me politika të duhura dhe të mirë analizuara IH sigurojnë stabilitet financiar , zhvillim ekonomik dhe përmirësojnë mirëqenie shoqërore.

Në kohën e zhvillimit të vrullshëm të IH-te , ishte e nevojshme krijimi i një procedure, një rregulle, e cila do të mbronte Investime të Huaja, por në të njëjtën kohë do t'i përkufizonte ato në çrregullimin e tyre, ku si pasojë krijohet Ligji Ndërkombëtar për Investimet e Huaja, i cili ishte një instrument për të ndikuar në Politiken neo-liberale edhe nëse zbatimi i të njejtit nënkuptonte ndryshimin e disa procedurave të së kaluarës.

2.1.1 Llojet e Investimeve të Huaja

Duke u bazuar në rishqyrtimin e literaturës mbi ndarjen e Investimeve të Huaja, ato mund të klasifikohen në bazë të kriteriumeve të ndryshme si vijon:

- 1) Investimet të huaja për nga forma se si ato mund të veprojnë gjatë blerjes së firmave jashtë shtetit mund të jenë :³

- a. *-Investim Greenfield* - i ashtuquajtur fushë e gjelbër që don të thotë se blerësi investon mjete dhe ndërmarrje tërësisht të re pra fillon nga zero .

³ Biznesi Nderkombetar -Nasir Selimi, fq. 188

- b. *Investim Acquiring or merging (M&AS)*- përvetësimi ose blerja e firmës ekzistuese lokale, është rasti kur investitori e ndërmerr firmën e cila ka funksionuar më parë .

Që të dyja format e investimit kanë përparësitë dhe të metat e tyre, por padyshim se forma e blerjes së ndërmarrjes ekzistuese për investorët është më favorizuese, pasi që nëpërmjet kësaj metode investorët kanë kthim më të shpejtë të mjeteve të investuara , ndërsa metoda e parë *investimi greenfiel* është më i pëlqyeshëm për vendin pritës, posaçërisht vendet në zhvillim ngase këtu investorët ndërtojnë objekte të reja, hapin vende të reja pune etj.

2) IH nga këndvështrimi i investorëve :

- a. IH Horizontale – prodhohet jashtë (në vendin pritës)
- b. IH Vertikale – transferohet jashtë një nga fazat e procesit prodhues
- c. IH konglomerat – janë një përzierje e investimeve horizontale dhe vertikale

3) Nga këndvështrimi i vendit pritës:

- a) IH zëvendësues të importit – përfshijnë prodhimin e mallrave që fillimisht janë importuar në vendin pritës
- b) IH rritës të eksportit -lidhen kryesisht me kërkimin e lëndëve të para apo edhe mallrave të ndërmjetëm
- c) IH të inicuar nga qeveritë – ka të bëjë me Politikën qeveritare që ofrojnë stimuj për investimet e huaja

- 4) Sipas Chryssochoidis, Millar & Clegg, 1997 ekzistojnë 5 lloje të ndryshme të Investimeve të Huaja:

Tipi 1 i IH – ndërmerren për të përfituar akses në faktorët specifik të prodhimit si resurset, njohuritë teknologjike dhe patentat të zotëruara në vendin pritës .Nëse faktorë të tillë nuk janë në dispozicion në vendin nikoqir dhe nuk janë mënyra të lehta për t'i bartur ato në vendin nikoqir, atëherë kompania detyrohet të investojë në vendin lokal për të siguruar qasje.

Tipi 2 i IH – kompania investon me qëllim akses në faktor më të lirë prodhimi si p.sh forca punëtore, zakonisht këto IH realizohen në vendet në zhvillim. IH të tilla mbështeten më shumë nga qeveritë, duke krijuar paketa taksore speciale për Investitorët dhe tërheqjen e tyre.

Tipi 3 i IH –të llojit “joint-venture “ lidhet me firmat të cilat konkurojnë në rang ndërkombëtar. Këto lloje të investimeve janë të përhapura në nivel të lartë si pasojë e rritjes së konkurrencës mes produkteve të ngjashme.

Tipi 4 i IH – ka të bëjë me IH që sigurojnë akses te konsumatorët e vendit pritës, qëllimi i këtyre IH është që t'u sigurojë produkte dhe shërbime konsumatorëve të vendit pritës njëjtë sikurse në vendin nikoqir.

Tipi 5 i IH – lidhet me aspektin e tregtimit të diversifikuar të integritit rajonal. Këto IH ndërmerren atëherë kur kompania në vendin nikoqir i ka kushtet lokale të nevojshme për prodhimtari, por ekzistenca e tarifave ose barrierave tjera të tregtisë i pengojnë kompanitë që të eksportojnë.

Duhet theksuar se qëllimi i çfarëdo lloji IH të lartpërmendura është maksimizimi i fitimit, zgjedhja e Investitorit për secilën prej këtyre llojeve do ta zgjedh për të investuar varet nga nevoja dhe mungesa e tij.

2.2 Rishikimi i literaturës së IH-ve dhe GDP-së

Shpesh pohohet me besim të plotë se Investimet e Huaja (IH) janë të dobishme për rritjen ekonomike në ekonominë e vendit pritës gjithashtu ekzistojnë studime të shumta empirike që konfirmojnë se IH janë përcaktues i rëndësishëm i rritjes ekonomike. Por, duhet potencuar se provat empirike janë të përziera, dhe mbeten boshllëqe në literaturë. Ekzistojnë bindje të ndryshme për efektin që mund të japin IH në vend dhe këto bindje janë të bazuara nga studimet empirike.

Borensztein and Lee (1995) nga studimi i tyre empirik për relacionin e IH-ve kundrejt rritjes ekonomike në vendet në zhvillim, treguan se IH janë mjet transferimi i teknologjisë dhe rritjes ekonomike më të lartë ku vendi pritës kishte një stok minimal të kapitalit njerëzor dhe në këtë rast vendi pritës kishte ndikim pozitiv nga IH. Në të kundërtën, kur vendi pritës ka nivele shumë të ulëta të kapitalit njerëzor pësojnë vetëm ndikim negativ nga IH.

Bos, Sanders and Secchi (1974) identifikuan një faktor që rrjedhonte nga IH me efekt negativ kundrejt rritjes ekonomike, shtrembërimet e çmimeve për shkak të proteksionizmit dhe monopolizimit dhe, së fundmi, burimeve natyrore.

Saltz (1992) shqyrtoi efektin e IH-ve në rritjen ekonomike për periudhën kohore (1970-1980). Rezultatet e testeve të tij empirike zbuluan një korrelacion negativ midis nivelit të IH-ve dhe rritjes ekonomike gjatë periudhës 1970-1980. Shpjegimet e tij pajtohen me ato të Bos, Sanders dhe Secchi (1974), që niveli i prodhimit të një vendi pritës do të ngecë në rastet e IH-ve kur mund të ndodhin monopolizime dhe transferime çmimesh, të cilat do të shkaktojnë nënzhvlerësimin e punës, të shkaktojë një ngecje në nivelin e kërkesës së konsumit dhe përfundimisht rritja ekonomike do të ketë ngecje të madhe.

Ndërsa në analizën empirike të zhvilluar në ekonominë e Maljziz , IH kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë e Malajzis. Përmes rezultateve empirike analiza tregon se ekziston një marrëdhënie pozitive në mes IH-ve dhe rritjes ekonomike të Malajsis për këtë analizë është shqyrtuar variabla GNI. Sipas këtij studimi zhvillimi i ekonomisë së vendit mund të arrihet duke inkurajuar më shumë IH të cilët mund të ndihmojnë në hapjen e vendeve të reja të punës me teknologji të zhvilluar ku do të ngriheshte edhe niveli i eksperiencës të forcës punëtore ku do të arrihet produktivitet më i lartë dhe plotësim i kërkesës së konsumatorëve. Në rastin e Malesize efekti negativ i IH-ve është te prodhuesit e vendit për shkak se ato po humbasin fuqinë e tregut përderisa Investitorët e Huaj luajnë rolin e monopolit .⁴

Gjithashtu nga analiza e zhvilluar në ekonominë e Spanjës jep shpjegimin e mëposhtëm: Gjatë viteve 1980, nën liberalizimin dhe integrimin ekonomik, IH globale u rritën. Prodhimi u bë gjithnjë e më ndërkombëtar. Graham dhe Krugman (1993) flasin për një valë të IH-ve, të drejtuara kryesisht në ekonomitë e industrializuara dhe duke e bërë Spanjën një nga importuesit më të mëdhenj të IH-ve. Spanja u bë gjithashtu një ndër dhjetë marrësit e IH-ve në mesin e vendeve të OECD në 2010 (Gjatë periudhës së vëzhgimit (1984–2010), IH-të në Spanjë u rritën mesatarisht me 47 % dhe stoku i IH-ve u rrit mesatarisht me 12.2 % (Banka e Spanjës / Banco de Espana 2011).⁵

⁴ International Business research -FDI and Economic Growth- An empirical Study on Malaysia Vol.1, No2 April 2008

⁵ Does Foreign Direct Investment Generate Economic Growth? A New Empirical Approach Applied to Spain Jorge Bermejo Carbonell, Richard A. Werner

Bhavya Malhotra në punimin e tij empirik - ndikimi i IH në Indi tregon se IH kanë pasur ndikim pozitiv në Indi , fluksi i IH-ve në Indi ka plotësuar kapitalin e brendshëm, teknologjinë si dhe aftësinë e kompanive ekzistuese, gjithashtu ka ndihmuar në krijimin e ndërmarrjeve të reja që ka ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike të ekonomisë Indiane. Politika e Investimeve të Huaja (IH)në Indi është liberalizuar gradualisht për ta bërë tregun më miqësor ndaj investitorëve. Rezultatet kanë qenë inkurajuese. Këto ditë, vendi rënditet vazhdimisht midis tre destinacioneve kryesore të investimeve globale nga të gjitha organet ndërkombëtare, përfshirë Bankën Botërore, informata nga raporti i KB-se. Investimet ne Indi fillimisht kanë filluar nga shteti Britanik në Indi dhe më pas në Luftën e Dytë Botërore kompanitë japoneze depërtuan në tregun e Indisë, qeveria e Indisë duke parë impaktin pozitiv të IH veproi direkt në ndërtimin e rrugëve të Indisë .⁶

2.3 Politikat dhe format tërheqëse për Investitorët e Huaj

Në çfarëdo lloj pike të zhvillimit të jetë një shtet, asnjëherë nuk e përjashton nevojën për të pasur Investime të Huaja. Për këtë arsye çdo shtet krijon politika dhe forma tërheqëse për Investitorët e Huaj .

Raporti i *Charles Oman* rekomandon një reformë të gjerë të politikë-bërjes duke përfshirë reformën rregullatore, privatizimin dhe liberalizimin e politikave tregtare (të jashtme si dhe të brendshme) si element kyç në një strategji të vendit në zhvillim për të tërhequr IH-të. Më tej

⁶⁶ https://www.ripublication.com/gjbmit/gjbmitv4n1_03.pdf

thekson nevojën për të rritur nivelet e llogaridhënies dhe transparencës për të kufizuar rrezikun e zhvillimit të praktikave të paligjshme në lidhje me strategjitë e tërheqjes së investitorëve.

Kushtet e vendit pritës janë faktorët kryesor që mund të ndikojnë në rritjen e suksesshmërisë të IH-ve . Kur faktorët e vendit pritës janë në nivel stabil është e pritur që edhe IH të kenë interesim më të lartë për të njëjtin vend.

Në mjedisin global ,faktorët e mëposhtëm janë si preferenca të IH-ve :

- Kushtet natyrore të vendit pritës – Resurset natyrore,
- Kapitali njerëzor me një aftësi diversive moderne – Resurset njerëzore,
- Disponueshmëria me faktorët e prodhimit,
- Lokacioni i vendit pritës dhe rregullimi i mjedisit,
- Lidhjet e transportit, me kosto më të ulët,
- Infrastrukturë e mirë në lëminë e telekomunikacionit, rrymës elektrike, transportit,
- Një mjedis i favorshëm me norma të ulëta dhe të qëndrueshme dhe politika efektive të konkurrencës,
- Kosto të ulët të transaksioneve dhe biznesit të punës, rregullat e hyrjes dhe daljes në vend,
- Politikat e hapura në aktivitetet e eksportit - domethënë tregtinë e lirë dhe regjimet e këmbimit valutor falas për të maksimizuar ekonominë e shkallës.

Table 1: Politikat dhe format tërheqëse për Investitorët e Huaj⁷

	Politikat industriale	Politikat makro-ekonomike	Politikat dhe faktorët e tjerë
Ndikimi i investitorëve të huaj potencialë	- Nxitje financiare dhe fiskale, negociatat - Administrim efikas, procedura dhe rregulla mbi pronësinë - Promovimi, targetimi dhe ndërtimi i imazhit - Zhvillimi i sektorëve kryesorë - Zhvillimi i platformave të eksportit TIRZ	- Infrastrukturë e disponueshme dhe fuqi punëtore e kualifikuar me marrëdhënie të mira pune - Paraqitja dhe perspektiva të shëndosha makroekonomike - Mundësitë e privatizimit - Zhvillimi i tregut financiar dhe gjendja e borxhit të jashtëm - Mospasja e barrierave për tregtinë e mallrave dhe shërbimet	- Integrimi global dhe rajonal ekonomik dhe shpenzimet e transportit - Marrëveshjet internacionale , rajonale dhe biraterale duke përfshirë BIT dhe WTO - Sigurimet (ICSID, MIGA, ECGD, OPIC) dhe vlerësimin e rrezikut politik - Vendndodhja pranë tregjeve të mëdha dhe të pasura - Disponueshmëria e burimeve natyrore - Lidhjet historike dhe përdorimi i gjuhës - Mungesa e korrupsionit dhe konflikti - Kushtet financiare në vendet e origjinës
Ndikimi i investitorëve të huaj ekzistues	- Sistemi i taksave / subvencioneve	Politika e tregut të punës	- Marrëveshjet e investimeve rajonale dhe ndërkombëtare
	- Kërkesat e performancës	Politikat tregtare, promovimi i eksporteve dhe infrastrukturë	- Integrimi ekonomik global
	- Ndërveprimi me institucionet për zhvillim dhe firma të tjera	Politika e konkurrencës	- Shoqëria civile
	- Inkurajimi i R&D	Zhvillimi i tregut financiar	
	- Trajnimi i të punësuarve		
Ndikimi në përgjigjen ndaj firmave vendore	- Inkurajimi i lidhjeve me TNC-të	- Edukimi dhe krijimi i aftësive	- Integrimi ekonomik global
	- Inkurajimi i aftësive teknologjike (R & D)	- Mobiliteti i punës	
	- Inkurajimi i burimeve njerëzore (trajnimi)	- Politika e konkurrencës	
		- Promovimi i eksportit	

⁷ <http://www.oecd.org/dev/2698620.pdf>

	-Menaxhimi anësor i furnizimit			
--	--------------------------------	--	--	--

2.3.1 Zonat Ekonomike

Zonat e veçanta ekonomike (të referuara edhe si zona të lira) përfaqësojnë zona gjeografike të përcaktuara brenda një ekonomie, ku veprimtaria e biznesit është subjekt i rregullave të ndryshme nga ato që mbizotërojnë në pjesën tjetër të ekonomisë. Këto rregulla mund të lidhen me kushtet e investimit, tregtinë, doganat dhe taksat etj. (Farole, 2011a).

Zonat ekonomike të lira paraqesin instrumentin kryesor i përdorur për tërheqjen e Investitorëve të Huaj , numri i zonave ekonomike të lira viteve të fundit është dëshifruar duke analizuar efektin e tyre pozitiv në ekonominë në zhvillim. Qëllimi kryesor i zonave është të tërheqë investime, sidomos IH të orientuara nga eksporti, dhe të krijojnë vende pune, duke ofruar incentiva të ndryshme fiskale dhe jofiskale për investitorët e zonës.

Lokacioni i zonave ekonomike duhet analizuar me kujdes në cilat qytete të shtetit duhet të ndërtohen, për shkak se Investitorët gjatë përzgjedhjes së zonës ku do të investojnë marrin në konsideratë, afërsinë ndaj kufijve kombëtarë, qasjes së afërt me forcën punëtore të kualifikuar për punë, afërsia me qytet përreth, infrastrukturën etj, domethënë këto zona duhet të vendosen pranë korridoreve kryesore të transportit (duke përfshirë portet dhe aeroportet), qytetet e mëdha, pranë universiteteve ose shkollat përkatëse profesionale ose në vendet e ish aktivitetit ekzistues industrial.

Fillimet e paketit të zonave ekonomike paraqiten qysh në vitet e 60-ta, konkretisht në Kandla të Indisë në vitin 1965. Mungesa e qeverisjes së mirë të politikës ekonomike të Indisë dhe menaxhimit joefikas së shpejti u bënë faktorë të dëmshëm për suksesin e këtyre zonave. I njëjti koncept rikonsiderohet në vitin 1990 ku edhe fillojnë rritjet intensive të zonave ekonomike ku sot ekzistojnë përafërsisht rreth 3000 zona ekonomike që operojnë në 120

vende të cilat llogariten për mbi 600 miliardë dollarë në eksporte dhe rreth 50 milion vende pune. Duke ofruar kushte të privileguara, zonat ekonomike tërheqin investime dhe shkëmbime të huaja, nxisin punësimin dhe nxisin zhvillimin e teknologjive dhe infrastrukturës së përmirësuar.⁸

Zonat mund të kenë forma të ndryshme të pronësisë. Në zonat publike dhe ato private, në zonat publike qeveria merr rolin e zhvilluesit, operatorit dhe rregullatorit të zonave, ndërsa në zonat private, kompanitë private zhvillojnë, menaxhojnë dhe operojnë zonat nën mbikëqyrjen e qeverisë. Zonat gjithashtu mund të funksionojnë si partneritete publike-private (PPP), ku qeveria merr pjesë në zhvillimin dhe funksionimin e zonës me qëllim që të inkurajojë pjesëmarrjen e sektorit privat në këtë projekt. Kjo mbështetje e qeverisë mund të marrë formën e zhvillimit të zonës fillestare, të cilën qeveria pastaj jep me qira ose kontraktin operatorët privatë për të menaxhuar sigurimin (si shërbimet komunale ose rrugët e kycjes) ose ofrimi i shërbimeve të tjera të tilla si vendosja e terminaleve doganore specifike të zonës (FIAS, 2008).

Zonat ekonomike përmbajnë dy lloje të faktorëve të tërheqjes së Investitorëve: *nxitjet tatimore* dhe *nxitjet jo-tatimore*. *Nxitjet tatimore* janë atraktive për investitorët, sepse zvogëlojnë detyrimet e tyre tatimore. Këto stimuj mund të marrin një numër formash, duke përfshirë pushimet tatimore, të cilat i përjashtojnë investitorët nga pagimi i të ardhurave të korporatave ose taksave të tjera, si dhe ndihmat për koston e kapitalit, ku investitorët marrin përfitime që lidhen me investimet e tyre kapitale. *Nxitjet jo-tatimore* mund të jenë mjaft të gjera nga procedurat e thjeshtuara administrative, të tilla si shërbimet qeveritare dhe procedurat e shpejta të doganave, për sigurimin e infrastrukturës ose kërkesa të thjeshtuara

⁸ <http://www.mightylaws.in/445/special-economic-zone-history-future>

ligjore dhe rregullatore. Këto shërbime shtesë mund të jenë po aq të rëndësishme sa stimujt e taksave në tërheqjen e investimeve në një zonë, por ndikimi i tyre varet nga rrethanat dhe llojet e incentivave tatimore që ofrohen.⁹

Investitorët e Huaj që operojnë në zona ekonomike kanë lidhje të drejtpërdrejta me fakultetet dhe shkollat teknike lokale me ç'rast ofrojnë programe praktike për trajnim të gjeneratave të reja, ku kjo rezulton në ngritjen profesionale të tyre, ku të njëjtin, të nesërmen mund të jenë të punësuar po në të njëjtin vend ku marrin praktikën ose aftësinë e përfituar mund ta shfrytëzojnë në kompanitë vendore që do të ketë efekt pozitiv në kompanitë vendore pasi që çdo praktikë nga IH-ve mbajnë cilësi të lartë. Gjithashtu, varësisht prej kërkesave dhe nevojave të tyre Investitorët e Huaj që operojnë në zonën ekonomike e kanë të lejuar të bashkëpunojnë, por jo për prodhimtari, me kompanitë vendore.

2.3.2 Zonat Ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Koncepti Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik në Republikën e Maqedonisë së Veriut nisi të potencohet në vitet 2000. Në gusht të vitit 2000 u themelua nga Qeveria e Republikës të Maqedonisë së Veriut. Me krijimin e Drejtorisë së Zonave të zhvillimit industrial teknologjik në janar të vitit 2002 ky koncept ishte zyrtarisht funksional. Gjatë vitit 2006, me zbatimin e mëtejshëm të strategjisë për zhvillim të shpejtë ekonomik të promovuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, hyrja e investimeve të huaja u caktua si prioritet i lartë, ku zonat e Zhvillimit Teknologjik Industrial morën rolin kryesor në përshejtimin e globalizimit ekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

⁹ http://www.oecd.org/south-east-europe/SEZ_WB_2017.pdf

Më 5 tetor 2006, u vendos gurthemeli i fabrikës së re të Johnson Controls, si investitori i parë i Zonës Teknologjike Industriale të Zhvillimit në Shkup 1. Projekti u përfundua dhe u aktivizua në fund të vitit 2007.¹⁰

Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik, në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut menaxhon Zonat e Zhvillimit Teknologjik Industrial në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka themeluar katërmëdhjetë Zonat e Zhvillimit Teknologjik dhe Industrial, të cilat janë të vendosura në një fazë tjetër të ndërtimit. Zonat zhvillimore teknologjike dhe industriale Shkup 1, Shkup 2 dhe Shtip janë plotësisht funksionale, gjithashtu funksionale është edhe TIDZ Tetovë për të cilën është nënshkruar Marrëveshja e Partneritetit Publiko-Privat me ndërmarrjen “Normak Investment”.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka investuar në paketat për zonat industriale ekonomike me qëllim që ato të jenë forma më atraktive për tërheqjen e Investitorëve të Huaj, bazuar në rishikimin e informacioneve nga faqja kryesore e drejtorisë për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik vijnë si më poshtë arsyet pse janë kaq të favorizueshme këto zona në RMV :

- 1) 10 LIRIMI VJETOR I TATIMIT - Investitorët në TIDZ kanë të drejtën për një përjashtim 10-vjeçar nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave dhe një reduktim 100% të tatimit mbi të ardhurat personale deri në 10 vjet. Investitorët janë të përjashtuar nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar për import dhe tregtim të mallrave në zonat e lira.

¹⁰ <http://fez.gov.mk/about-us/?lang=MK#1516610898513-f1f141ee-3d22bc63-5cc5>

Përveç kësaj, investitorët janë të përjashtuar nga pagesa e detyrimeve doganore për pajisjet, makineritë dhe pjesët rezervë.

- 2) Toka në TIDZ jepet me qira afatgjatë për një periudhë deri në 99 vjet.
- 3) Investitorët përjashtohen nga pagimi i taksave komunale.
- 4) Lidhja e papagesës me rrjetin e gazit, ujit dhe kanalizimit.
- 5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të mbështesë rritjen e investimeve kapitale dhe të ardhurave duke kthyer 10% të kostos së investimeve në makineritë dhe pajisjet e reja, ose investimet në ndërtesa dhe tokë deri në maksimum prej 1 milion euro për një periudhë 5 vjeçare.

Ne tabelën 2 do të paraqesim paketin për tarifat tatimore dhe doganore si paket më atraktiv për tërheqjen e Investitorëve, të formuar dhe të përkrahur në maksimum nga qeveria e RMV-së.

Tabela 2: Përparësitë krahasuese ¹¹

Tarifat Tatimore		
	Jasht Zones	NE ZONE
TVSH	18%	0%
Tatimi mbi të ardhurat Koperative	10%	0% for 10 years
Tatimi në të Ardhurat Personale	10%	0% for 10 years
Tarifat Doganore		
	Jasht Zones	NE ZONE
Produktet		
Lenda e Pare	0% - 15%	0%
Mjete	5% - 20%	0%

Investitorët e huaj janë ato të cilët analizojnë çdo detaj përpara se të vendosin për investimin e tyre konkret, për ata është shumë e rëndësishme stabiliteti ekonomik, politik, financa të vendit pritës edhe pse vendi pritës mund të ofrojë paketa të ndryshme tërheqëse, nëse Investitori nuk ka siguri ekonomike financiare dhe politike të tjerat bien poshtë. Një ndër pikat të cilat gjithashtu rishqyrtohen nga Investitorët janë marrëveshjet ndërkombëtare të vendit pritës, të cilat janë shumë të rëndësishme për lëvizshmërinë e tyre më të lehtë nga shteti pritës te shteti nikoqir , por edhe te shtetet tjera ku ndoshta veçse funksionon.

Maqedonia është nënshkruese e tre marrëveshjeve të tregtisë së lirë shumëpalëshe:

- MSA-(SAA) (Marrëveshja e Stabilizim Asociimit) me Shtetet Anëtare të BE-së

¹¹ <http://fez.gov.mk/why-invest/?lang=MK>

- EFTA (Zvicër, Norvegji, Islandë dhe Lihtenshtajn)
- CEFTA (Maqedonia, Shqipëria, Moldavia, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova)

Gjithashtu, marrëveshjet bilaterale të tregtisë së lirë janë nënshkruar me Turqinë dhe Ukrainën.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka nënshkruar marrëveshje për mbrojtjen e investimeve me këto vende: Shqipëria, Serbia, Bullgaria, Turqia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovenia, Rumania, Austria, Gjermania, Zvicra, Holanda, Belgjika, Franca, Italia, Spanja, Hungaria, Republika Çeke, Polonia, Ukraina, Suedia, Finlanda, Rusia, Republika Popullore e Kinës, Malajzia, Koreja e Jugut dhe India.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka nënshkruar marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë me vendet e mëposhtme: Shqipëria, Austria, Bjellorusia, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Danimarka, Egjipti, Estonia, Britania e Madhe, Hungaria, Irani, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Franca, Hungaria, Maroku, Moldavia, Holanda, Republika Popullore e Kinës, Polonia, Rumania, Rusia, Sllovakia, Sllovenia, Ukraina, Tajvani, Republika e Kinës, Turqia dhe Katari.

2.4 Avantazhet dhe disavantazhet që shoqërojnë IH-të

Investimet e huaja si çdo fenomen tjetër kanë anët pozitive dhe negative si në vendin pritës ashtu edhe në vendin nikoqir, në këtë pjesë do të analizojmë literaturën mbi avantazhet dhe disavantazhet e IH-ve në vendin pritës .

Avantazhet kryesore të vendit pritës nga IH-te rrjedhin nga efekti i shpërndarjeve të resurseve, efekti i rritjes së punësimit , efekti i bilancit të pagesave , efekti i konkurrencës dhe rritja ekonomike :¹²

- Efekti i shpërndarjeve të resurseve – IH krijojnë ndikim pozitiv në vendin pritës nëpërmjet efektit të shpërndarjes së resurseve siç janë me aplikimin e kapitalit, teknologjisë dhe resurset e menaxhimit. *Kapitali* paraqet element kryesor në procesin e prodhimit, kompanitë multinacionale janë të njohura për kapital të madh , gjë që me investimin e tyre e bartin me vete ku bankat vendore kanë më shumë besim dhe japim kredi për investime të llojit të ndryshëm. Teknologjia-transformimi i teknologjisë ka efekt pozitiv në ngritjen profesionale të vendit mikpritës. Resurset e menaxhimit nënkupton ndikimi i menaxherëve me përvojë, njohuri dhe aftësi që bartin te vendi pritës.
- Efekti i rritjes së punësimit – Rritja e numrit të punëtorëve është qëllimi kryesor i çdo ekonomie. IH ndikojnë në rritjen e punëtorëve në dy forma : *direkte* – kompania që investon apo krijon vende të reja pune dhe punëson numrin e nevojshëm të punëtorëve ,*indirekte* – kompania që investon kërkon furnizime me materiale, pra logjistikën të cilën e siguron nga firmat vendase, ku tek të njëjtat paraqitet nevoja për rritjen e numrit të punëtorëve.

¹² Global Business Today – sixth edition – Hill , fq 256

- Efekti i bilancit të pagesave- Shqetësimi i çdo shteti është që në fund të vitit të mos ketë bilanc deficitar të pagesave, vendi i cili rezulton me bilanc deficitar të pagesave ka pasoja dhe reperkusione negative në zhvillimin ekonomik. Me ndikimin e IH –ve, kemi zmadhim të eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe rritjen e devizave në vend që ka ndikim pozitiv në vendin pritës .
- Efekti i konkurrencës dhe rritja ekonomike – Konkurrenca rrit kualitetin dhe kuantitetin e mallrave. IH me vete bartin cilësi të lartë të produkteve kështu që firmat vendore do të tentojnë në maksimum t'i afrohen cilësisë konkurruese me ç'rast oferta rritet , kërkesa konstante ka ulje të çmimeve e kjo çon në rritjen e mirëqenies dhe standardin e qytetarëve .

Disavantazhet kryesore të vendit pritës nga IH-te rrjedhin nga efekte negative në konkurrencë, efekte negative në bilancin e pagesave dhe humbja e sovranitetit dhe autonomisë kombëtare .

- Efekte negative në konkurrencë zakonisht ndodh në vendet në zhvillim apo në tranzicion pasi që kompanitë vendore janë aq të vogla sa nuk mund t'u bëjnë ballë kompanive multinacionale dhe kjo rezulton në shkrirjen e këtyre kompanive vendore, gjithashtu në raste kur kompania multinacionale ka për qëllim të fiton pozitën monopoliste, ku kemi rritje të çmimeve, ndërkaq në anën tjetër dëmtohen konsumatorët vendor.
- Efekte negative në bilancin e pagesave ndodh atëherë kur firma që investon tërë fitimin e realizuar e kalon në vendin nikoqir, dhe kjo shkakton derdhjen e madhe të devizave në vendin pritës gjë që e keqëson bilancin e pagesave.
- Humbja e sovranitetit dhe autonomisë kombëtare ndodh sepse vendi mikpritës nuk mund të ndikojë në vendimet e kompanisë multinacionale.

Kapitulli III

Investimet të Huaja në Republikën e

Maqedonisë së Veriut


Në pjesën e parë të këtij kapitulli fokus më të madh do të ketë historiku i zhvillimit të ekonomisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhë të caktuar kohore, faktorët kryesor të ngecjes së ekonomisë, por gjithashtu faktorët kryesor të nëpërkëmbjes të së njëjtës. Ndërkaq, në pjesën e dytë do të vazhdojmë me analizën detale të trendeve të Investimeve të Huaja në GDP e RMV.

3.1 Zhvillimi Ekonomik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Që nga viti 1990 Republika e Maqedonisë së Veriut është hasur me probleme të shumta duke filluar nga lufta për pavarësinë dhe sovranitetin e saj e deri te rregullimi i brendshëm politik dhe ai internacional. Gjatë gjithë periudhës së zhvillimit ekonomik reformat kanë lëvizur në formë të qëndrueshme, por disa fenomene kanë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike të vendit siç janë: korrupsioni, mungesa e financimit (lack offinance) dhe mjedisi rregullativ i paqartë. Këto faktorë gjithashtu kanë ndikuar negativisht në tërheqjen e investimeve të huaja në RMV ku si pasojë kemi pasur edhe rritje të lartë të nivelit të normës së papunësisë. Pas ndarjes nga ish-Jugosllavia, Maqedonia e Veriut renditej ndër vendet më të varfëra dhe me shkallë shumë të lartë të papunësisë. Në fillim të vitit 1990, qeveria ndërmorri hapa për privatizimin duke shpresuar për rregullimin ekonomik të saj. Që nga pavarësia e RMV, norma e rritjes ekonomike gjithmonë ka qenë e ndryshueshme, gjë që bënte të pasqyrohet një ekonomi jo stabile dhe e paqëndrueshme.

Në figurën më poshtë do të analizojmë GDP e RMV për periudhën kohore nga viti 1991-2019 , si një ndër matësit kryesorë të ekonomisë së një vendi.

Figura 1. Rritja reale e GDP se RMV për periudhën kohore (1991-2019) :



Burimi: Nga të dhënat e Bankës Botërore

Nga figura nr.1 shohim se GDP e RMV nga viti 1991-1995 është vazhdimisht në rënie dhe për herë të parë ky indikator i rëndësishëm i ekonomisë rezulton pozitiv me 1.2% në vitin 1996, kjo tendencë rritjeje vazhdon deri në vitin 2001, deri në fillimin e luftës në Maqedoni ku përsëri ky indikator i rëndësishëm shkon në -4.5%. Pas luftës, në vitet në vazhdim ekonomia e RMV ka një tendencë të rritjes pozitive shumë modeste.


Krahasuar me pjesën tjetër të vendeve të Evropës Juglindore, Maqedonia e Veriut që nga viti 2009 ka pasur një rritje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme të ekonomisë. Rritja e GDP-së është llogaritur në vitin 2008 duke qenë 0.4%, megjithatë në vitet e ardhshme ajo tregoi një rritje të konsiderueshme duke arritur 3.4% dhe 2.3% përkatësisht në 2010-2011. Ndër gjashtë vendet që përfaqësojnë SEE rajoni, rritja më e lartë e GDP-së për vitin 2014 ishte Maqedonia e Veriut. Parashihej rritje me 3%, kryesisht të bazuar në prodhim, ndërtim dhe eksportet e IH-ve të cilat u zhvilluan në Maqedoninë e Veriut gjatë vitit 2014. Për më tepër, shërbimet gjithashtu kishin kontributin e tyre në rritjen e GDP -së kryesisht tregtia me pakicë dhe pasuritë e patundshme.

3.2 Trendet e IH-ve në Maqedoninë e Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut llogaritet si vend në zhvillim, ky fakt i jep arsye që Maqedonia e Veriut gjatë gjithë periudhës së saj të zhvillimit është ballafaquar me normë të lartë të papunësisë dhe zhvillim të ngadalshëm ekonomik, ku shpresa për përmirësimin e gjendjes ekonomike të vendit ishte dhe do të mbetet ndikimi i Investimeve të Huaja (IH-ve). Duke pasur target IH-te , vendi ka tentuar gjithmonë të bëjë politika tërheqëse për të njëjtat. Nga raporti i Bankës Botërore, Maqedonia radhitet në vendin e 17 në mes 190 vendeve për mënyrën më të lehtë për të investuar apo kryer biznes.

Në fillim të viteve 1990 fluksi i IH- ve në RMV ishte shumë i ulët , si pasojë e problemeve të brendshme politiko-sociale dhe rrethanave të pavorshme për investitorët. Por, ky fluks ndryshoi dramatikisht nga momenti i privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe blerjeve nga firmat e huaja pergjithësisht në sektorin bankar dhe atë të telekomunikacionit.

Figura 2. Investimet e Huaja në RMV për periudhën kohore (1994-2019)



Burimi: Nga të dhënat e Bankës Botërore

Nga figura 2, vijon analiza e mëtejshme se Investimet të Huaja përgjatë periudhës kohore 1990-1996 kanë qenë vetëm 64 milion dollarë, prej të cilave 30 milion dollarë janë krijuar nga procesi i privatizimit. Një rritje të dukshme të IH -ve në RMV kemi në 1998 edhe atë shkon në 150 milion dollarë, mirëpo kjo rritje shoqërohet menjëherë me një rënie për 88 milion dollarë në vitin 1999 si pasojë e politikës jo stabile dhe krizave në rajon. Nga e gjitha kjo kemi një përfundim se në këtë periudhë kohore IH në RMV kanë një zhvillim të ulët, por gjithashtu duhet potencuar se nga të dhënat në tabelë shohim se në periudhën 1998-2014 fluks të madh të IH-ve ka pasur në vitin 2001 dhe 2007, ku në 2007 realizon mbi 700 milion dollarë investim të IH-ve .


Ky ndryshim i fluksit të IH-ve ndodhi menjëherë pas shitjes së disa ndërmarrjeve shtetërore konkretisht me privatizimin e shumë kompanive shtetërore siç janë "Banka Ekonomike" - Shkup, "ADOR"- Shkup, "Feni" - Kavadarç, "Buçim" - Radovish,"Kombinati i mermerit "- Prilep," Larnica "- Ohër, " Brewery "- Manastir etj., (Hourvouliades & Davcev, 2014).

Nga raporti i Bankës Botërore tregojnë se në RMV fluks të lartë të IH kanë pasur në vitin 2001 me shitjen e operatorit kombëtar të Telekomunikacionit të "Magyar Telecom" i cili në të njëjtën kohë ishte partner me "Deutsche Telekom".

Nga gjendja jo stabile ekonomike politike këto indikatorë të rëndësishëm siç janë IH do të variojnë nga viti në vit që pasqyrojnë jo seriozitetin e vendit për mirëmbajtjen e tyre, ndërkajë në figurën 2 kemi përsëri një ringjallje në vitin 2007 kryesisht si pasojë e shitjes së ndërmarrjes elektike . Sidoqoftë IH në RMV do të pësojnë përsëri një ulje të zhvillimit të tyre si pasojë e krizës ekonomike ku do të rezultojë në një ulje shumë të madhe në vitin 2014 dhe ngritje të dukshme të tyre do të vërehet në vitin 2018.


Nga kjo mund të rrumbullaksojmë që 40 përqind e IH-ve totale në vend vënin kryesisht nga projektet Greenfield (UNCTAD).

Figura 3. Investimet të Huaja në RMV duke u bazuar nga origjina (2003-2019)



Burimi : Nga Banka Popullore e RMV

Figura 4. Pjesëmarrja e IH-ve në % në bazë të origjinës (2003-2019)



Burimi : Nga Banka Popullore e RMV

Duke u bazuar në grafikonet me të dhënat nga Banka Popullore e RMV mund të konkludojmë se investorët më potencial të RMV të periudhës kohore nga 2003-2019 paraqiten nga origjina e vendeve të ndryshme siç janë: Austria me 22 % , Holanda 18 % dhe Sllovenia me 18% . Por nuk duhet anashkaluar pa potencuar se kjo % ka vajuar nga viti në vit dhe nuk duhet të mbetën pa potencuar një ndër investorët potencial të RMV siç janë IHD nga Greqia të cilët kanë qenë në fillim të kësaj periudhe si investorët më të pranishëm në RMV, por për shkak të problemeve politike kemi dhe tërheqjen e tyre nga RMV, investorët grek kanë investuar në sektore të ndryshme, por në veçanti në sektorin bankar (Banka Kreditore nga Alfa Bank, Banka Ekonomike nga Banka Nacionale e Greqisë) refinimi i naftës (OKTA) dhe industria përpunuese (Brewery Shkup).

Investimet të huaja me origjinë nga Austria më shumë janë nga sektori i distribuimit të energjisë elektrike, konkretisht nga kompania e mirënjohur e energjisë EVN .

Investimet të huaja me origjinë nga Holanda më shumë janë të theksuara nga projekti Metal Steel .

Investimet të huaja me origjinë nga Sllovenia janë të përfshirë në më shumë sektore siç janë sektori bankar “Nova Ljubljanska Banka” , në sektorin e telekomunikacionit (kompania e mirënjohur dhe shumë dominuese ONE) dhe në sektorin e pasurive të patundshme (Mercuri, ERA, UNCTAD).

Duke pasur parasysh gjithnjë problemet ekonomike dhe politike që është hasur RMV sidomos me fqinjët e saj, konflikti me Greqinë për çështjen e emrit, përsëri mund të themi se RMV ka tërhequr IH të konsiderueshme të cilat kanë pasur ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit, por gjithnjë mbetet hapësirë për një rritje të IH me shkallë më të lartë.

Sipas indekseve potenciale të UNCTAD-it RMV ka performuar në mënyrë më të mirë në tërheqjen e IH-ve, se vet potenciali i saj. Në vitin 2008 sa i përket performancës së IH-ve Republika e Maqedonië së Veriut u rendit në vendin e 44 nga 141 ekonomi të përfshira.

Tabela 3. TOP 10 Investimet më të mëdhaja në RMV (2001-2008)

Investor	Home Country	Target Company	Amount of investment (\$million)
Magyar Telekom (Deutsche Telekom)	Hungary (Germany)	Makedonski Telekom	346.5
EVN	Austriia	ESM Distribution	270.2
National Bank	Greece	Stopanska Banka	46.4
Balkanbrew Holding	Greece	Brewery	34
Hellenic Petroleum	Greece	OKTA	32
Société Générale	France	Ohridska Banka	30.4
Titan	Greece/Switzerland	Usje Cement Factory	30
Balkan Steel	Liechtenstein	Ladna Valalnica	21
QBE Insurance	United Kingdom	ADOR Makedonija	14.8
Duferco	Switzerland	Makstil	11.5

Burimi :UNCTAD

Në figurën 2 kemi paraqitur Investime të Huaja me potenciale në RMV në periudhën kohore 2001-2008 , të cilat kanë lënë një impakt pozitiv në ekonominë e vendit , duke sjellur teknologjinë e re në vendin dhe duke hapur vende të reja pune.

Ndikimi i IH në zhvillim ekonomik dhe social të një vendi matet në terma të kontributit të tij pozitiv në prodhim, punësim, diversifikim të eksportit, transformimin e teknologjisë dhe aftësisë, lidhjet e furnitoreve si dhe të ardhurat fiskale dhe zhvillimi i infrastrukturës , gjë që gjatë kësaj periudhe në RMV këto indikatorë kanë pasur ndikim pozitiv.

3.3 Përbërja sektoriale e IH-ve në RMV

Një analizë e ardhme në këtë punim është pjesëmarrja e IH-ve në RMV në bazë të sektorit ku janë me shumë pjeësmarrës. Bazur nga të dhënat nga Banka Popullore e RMV veçohen këto sektorë: bujqësia , ndërtimtaria, shërbimet dhe prodhimtaria .


- Bujqësia -kushtet klimatike, traditat dhe aftësitë e popullatës së RMV bëjnë bujqësinë sektor veçanërisht të rëndësishëm por kjo nuk do të thotë se i njëjti sektor do të ishte objektiva kryesore e IH –ve. IH në RMV në sektorin e bujqësisë bëjnë pjesë vetëm 2%

për periudhë kohore (2009-2019). Ndërkaq, duhet theksuar se IH në mbarë botën nuk janë të fokusuara në këtë sektor.

- Prodhimtaria – Republika e Maqedonisë së Veriut është e pasur me minerale metalike dhe burime ujore duke e bërë atë si një destinacion tërheqës për prodhimin e çelikut. Duferco (Zvicër) depërtoi në RMV në vitin 1997 me privatizimin e ndërmarrjes së Minierave&Hukuranave dhe Çelikut SHKUP. Duferco filloi një program intenziv me një investim fillestar prej 15 milion euro në 1999 dhe me një investim pasues në vitin 2007 prej 22 milion euro. Ky sektor për periudhën kohore 2009-2019 përfshihet me 43%.
- Shërbimet – Një ndër sektorët më të fokusuar nga IHD në RMV këto bëjnë pjesë shërbimet e shpërndarjes së rrymës elektrike, telekomunikacionit, aktivitete bankare etj, ku në RMV, IH në këtë sektor përfshijnë pjesën më të madhe me 45 % .
- Ndërtimtaria – si një vend në zhvillim ky sektor përfshin 10% të IH-ve në RMV .

Në figurën më poshtë kemi paraqitur pjesëmarrjen e IH- ve në RMV në baze të sektorit, ku vërejmë se përqindje më të madhe të IH-ve ka në sektorin e prodhimtarisë me 45% ku më pas i bashkangjitet sektori i shërbimeve me 43%. Për periudhën kohore (2009-2019).

Figura 5. Investimet e Huaja në RMV sipas sektorit (2009-2019)




Burimi : Banka Popullore e RMV

3.4 Analizë grafike e ndikimit të investimeve të huaja në zhvillimin ekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Sic kemi rishqyrtuar deri më tani literaturën mbi ndikimin e IH -ve që ekzistonin teori se IH kanë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të një vendi në zhvillim, rast kontret kemi rastin e RMV ku shohim se sa më të larta të jenë Investimet e Huaja, aq më e lartë do të jetë edhe norma e rritjes së ekonomisë së vendit pritës. Si fillim ashtu edhe në vazhdim do ta shqyrtojmë këtë lidhje me një pikë grafike e më pas do të analizojmë në mënyrë empirike.

Figura 6. Interpretimi i GDP dhe IH-ve në RMV për periudhën kohore (2009-2019)



Burimi : Banka Botërore

Nga figura 6 mund të konstatojmë se GDP dhe IH kanë një lidhje /relacion të ndërsjellë, sa më i lartë të jetë faktori GDP, po aq kemi edhe rritje të IH-ve. Ky korrelacion pozitiv vërteton se në vendet në zhvillim me një ekonomi stabile kemi rritje të IH-ve varësisht GDP.

4.0 KAPITULLI IV

Metodologjia e kërkimit

Qëllimi i këtij punimi është të analizojmë ndikimin e Investimeve të Huaja kundrejt GDP në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për të realizuar këtë analizë të punimit, të dhënat do të grumbullohen nga Banka Botërore për periudhën kohore (2000-2019) të RMV. Për përfundimin empirik janë përdorur dy variabla kryesore siç janë: Investimet e Huaja (IH) dhe GDP e vendit për periudhën kohore (2000-2019). Të dhënat e mbledhura do të analizohen në bazë vjetore.

4.1 Metodologjia

Në këtë punim do përdorim metodën e regresionit për të arritur në rezultate, gjithashtu do të përdorim dhe mikrosoft excel për të bërë analizën empirike të korrelacionit midis IH-ve dhe GDP-se në RMV. Ky studim mbështeten në një ekuacion të regresionit : *Ndikimi i IH-ve në GDP e RMV -es*.

$$Y_i = \beta_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \mu_i$$

Regresioni paraqet lidhjen në mes të dy apo më shumë dukurive prej të cilave njëra është e varur kurse tjetra e pavarur. Rast i parë Variabla e varur (Y) është ajo variabël e vlerësuar të cilën ne dëshirojmë ta shpjegojmë, në rastin tonë IH. Variabla(t) e pavarur (X) është ajo lloj variabëlë që siguron bazën për vlerësim, që përdoret për të shpjeguar variablën e varur, në rastin tonë rritja e PBB për kokë banori.

$$\log (IH) = \beta_0 + \beta_1 (\log GDP) + \mu_i$$

Ku,

(GDPI) = Prodhimi i Brendshëm Bruto i Maqedonisë

α_2 = Përgjimi për ekuacionin

(IH)= Investimet e Huaja në Maqedoni

β_2 = Koeficienti i pjerrësisë së Investimeve të Huaja

v_i = Term gabimi për ekuacion

- (i) LogIh është ndryshorja e hyrjeve neto të IH-ve , që paraqet variabël të varur
- (ii) Loggdp është ndryshorja e rritjes reale të PBB-se për banorë, që paraqet variabël të pavarur dhe koeficientet β_0, β_1 .

4.1.1 Ekuacioni regresiv midis investimeve dhe PBB

Lidhja e dy variabaleve do te realizohet me anë të të dhënave empirike – funksionit linear LOG LOG.

Ndryshoren e varur dhe atë të pavarur në modelin tonë do t'i konvertojmë në ekuacion linear me përdorimin e logaritmeve. Procedura e regresionit vijon kështu: (I) se pari kalkulojmë vlerat e logaritmuara të të dhënave origjinale; (II) së dyti i vendosim në regresion ndryshoret tashmë të logaritmuara dhe (III) së fundmi e vlerësojmë koeficientin e regresionit.

4.1.2 Analiza e regresionit të testit të shkakësisë - Granger

Qasja e Granger-it ndaj pyetjes nëse X shkakton Y-në është të shihet se sa nga Y-ja aktuale mund të shpjegohen vlerat e kaluara të Y-së dhe më pas të shihet nëse shtimi i vlerave të vonuara të X mund të përmirësojë shpjegimin. Y thuhet se shkaktohet nga Granger nga X nëse X ndihmon në parashikimin e Y, ose në mënyrë ekuivalente nëse koeficientët në X e vonuara janë statistikisht domethënë. Vini re se shkak i dyanshëm ndodh shpesh. X Granger shkakton Y dhe Y, gjegjësisht Granger shkakton X. Është e rëndësishme të theksohet se thënia “X Granger shkakton Y dhe nuk nënkupton që Y është efekti ose rezultati i X. Kjo teknikë nuk nënkupton një masë të duhur të shkakësisë, por një hetim nëse informacioni i kaluar i x përmirëson parashikimin e y.

Marrë në aspektin statistikor, përpiqet të masë nëse përfshirja e informacionit të kaluar në x redukton gabimin mesatar katror të ekuacionit. Testi i shkakësisë së Granger mat përparësinë dhe përmbytjen e informacionit, por nuk tregon në vetvete kauzalitetin në përdorimin më të zakonshëm të termit. Ne, domethënë, mendojmë për një sistem me dy ekuacione që e shprehin atë qartë, si p.sh. auto-regresionin e mëposhtëm ose vektorial sipas vektorit të kolonës së (X,Y).

Ne fillimisht vlerësojmë një model autoregresioni vektorial, duke marrë parasysh numrin e vogël të shkallëve të lirisë që në rastin tonë për shkak të kufizimeve të të dhënave është mjaft i vogël.

```
var L.gdpgrowthannual L.foreigndirectinvestmentnetinflow
```

Vector autoregression

Sample:	2012 - 2019	Number of obs	=	8
Log likelihood =	-171.5778	AIC	=	45.39446
FPE	= 2.74e+17	HQIC	=	44.72471
Det(Sigma_ml)	= 1.46e+16	SBIC	=	45.49376

Equation	Parms	RMSE	R-sq	chi2	P>chi2
-----	-----	-----	-----	-----	-----
L_gdpgrowthann~1	5	1.31899	0.6389	14.1567	0.0068
L_foreigndirec~1	5	2.4e+08	0.2044	2.055168	0.7256
-----	-----	-----	-----	-----	-----


```

-----
---
Interval] | Coef. Std. Err. z P>|z| [95% Conf.
-----+-----
L_gdpgrowthannual |
      gdpgrowthannual |
      L2. | -.0905166 .3633035 -0.25 0.803 -.8025783
.6215452
      L3. | -.238216 .1796696 -1.33 0.185 -.590362
.1139301
foreigndirectinvestmentnetinflow |
      L2. | -6.75e-09 2.30e-09 -2.93 0.003 -1.13e-08 -
2.24e-09
      L3. | 8.83e-10 3.39e-09 0.26 0.795 -5.77e-09
7.53e-09
      _cons | 5.226734 2.504598 2.09 0.037 .317812
10.13566
-----+-----
L_foreigndirectinvestmentnetinfl |
      gdpgrowthannual |
      L2. | -5.11e+07 6.74e+07 -0.76 0.448 -1.83e+08
8.10e+07
      L3. | 3.59e+07 3.33e+07 1.08 0.282 -2.95e+07
1.01e+08
foreigndirectinvestmentnetinflow |
      L2. | -.2523868 .4271206 -0.59 0.555 -1.089528
.5847542
      L3. | -.367577 .6292635 -0.58 0.559 -1.600911
.8657567
      _cons | 6.56e+08 4.65e+08 1.41 0.158 -2.54e+08
1.57e+09
vargranger

Granger causality Wald tests
+-----+-----+-----+-----+-----+
| Equation | Excluded | chi2 | df | Prob > chi2 |
+-----+-----+-----+-----+-----+
| L_gdpgrowthannual L.foreigndirect~w | 10.907 | 2 | 0.004 |
| L_gdpgrowthannual ALL | 10.907 | 2 | 0.004 |
+-----+-----+-----+-----+-----+
| L_foreigndirect~l L.gdpgrowthannual | 2.0408 | 2 | 0.360 |
| L_foreigndirect~l ALL | 2.0408 | 2 | 0.360 |
+-----+-----+-----+-----+-----+

```

Le të fillojmë me shqyrtimin e rezultateve të testeve për ekuacionin e parë. I pari është një test Wald që koeficientët e logaritmit të IH-ve që shfaqen në ekuacionin e rritjes së PBB-së janë zero. Hipoteza zero se IH (logaritmi natyror i IH-ve) nuk shkakton GDP-në nga Granger mund të hidhet poshtë. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për shkakësinë Granger të PBB-së mbi IH. Kështu, rezultatet tregojnë se IHD-të shkaktojnë variablat e GDP-së nga Granger.

Tani vazhdojmë me modelin e zgjeruar me përcaktuesit e tjerë të rritjes ekonomike të zgjedhur për t'u përfshirë si variabla të tjerë si: papunësia si përqindje e popullsisë së përgjithshme. E njëjta qasje metodologjike kryhet më tej.

```
. var foreigndirectinvestmentnetinflow unemploymenttotaloftotallaborfor
```

Vector autoregression

```
Sample: 2011 - 2019                                Number of obs   =          9
Log likelihood = -184.7298                          AIC             =   43.27328
FPE           =  2.83e+16                          HQIC           =   42.80038
Det(Sigma_ml) =  2.31e+15                          SBIC           =   43.49242
```

Equation	Parms	RMSE	R-sq	chi2	P>chi2
foreigndirecti~w	5	1.3e+08	0.7012	21.1254	0.0003
unemploymentto~r	5	.887541	0.9832	526.3953	0.0000

		Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]
foreigndirectinve~w						
foreigndirectinve~w						
	L1.	-.0411988	.2028628	-0.20	0.839	-.4388027 .3564051
	L2.	-.5905522	.25517	-2.31	0.021	-1.090676 -.0904282
unemploymenttotal~r						
	L1.	1.97e+08	5.45e+07	3.62	0.000	9.03e+07 3.04e+08
	L2.	-2.49e+08	6.21e+07	-4.01	0.000	-3.70e+08 -1.27e+08
	_cons	2.34e+09	4.47e+08	5.24	0.000	1.47e+09 3.22e+09
unemploymenttotal~r						
foreigndirectinve~w						
	L1.	9.41e-10	1.37e-09	0.69	0.492	-1.74e-09 3.63e-09
	L2.	1.22e-09	1.72e-09	0.71	0.480	-2.16e-09 4.59e-09
unemploymenttotal~r						
	L1.	.7228948	.3680034	1.96	0.049	.0016215 1.444168
	L2.	.5148871	.4191883	1.23	0.219	-.3067069 1.336481
	_cons	-9.555856	3.019815	-3.16	0.002	-15.47458 -3.637128

. vargranger

Granger causality Wald tests

Equation	Excluded	chi2	df	Prob > chi2
foreigndirectin~w unemploymenttot~r		21.019	2	0.000
foreigndirectin~w	ALL	21.019	2	0.000
unemploymenttot~r foreigndirectin~w		.97928	2	0.613
unemploymenttot~r	ALL	.97928	2	0.613

Null Hypothesis	Obs	F-stat	Prob
GDP does not Ganger Cause FDI	8	10.907	0.004
FDI does Ganger Cause GDP		2.0408	0.360
Unemployment does Ganger Cause FDI	9	21.019	0.000
FDI does not Ganger Cause Unemployment		0.979	0.613

Konkluzionet:

1.GDP nuk ndikon te Investimet e Huaja

2. Investimet e Huaja ndikojn në GDP

3.Papunësia nuk ndikon në Investimet e Huaja

4.Investimet e Huaja ndikojnë në normën e papunësisë.

GDP nuk ndikon te Investimet e Huaja

GDP ose Prodhimi i Brendshëm Bruto është treguesi ekonomik që paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale. PBB-ja është një ndër treguesit kryesorë makroekonomikë për të matur rritjen ekonomike. PBB-ja reale përfshin mallrat dhe shërbimet përfundimtare të matura me çmime konstante. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) është vlera

monetare e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të gatshme të bëra brenda një vendi gjatë një periudhe të caktuar. GDP ofron një pamje ekonomike të një vendi, e përdorur për të vlerësuar madhësinë e një ekonomie dhe normën e rritjes. PBB-ja mund të llogaritet në tre mënyra, duke përdorur shpenzimet, prodhimin ose të ardhurat. Mund të rregullohet për inflacionin dhe popullsinë për të ofruar njohuri më të thella.

Megjithëse ka kufizime, GDP është një mjet kyç për të udhëhequr politikëbërësit, investitorët dhe GDP është një nga masat më të përdorura gjerësisht të prodhimit apo prodhimit të ekonomisë. Përkufizohet si vlera e përgjithshme e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara brenda kufijve të një vendi në një periudhë të caktuar kohore - mujore, tremujore ose vjetore. GDP është një tregues i saktë i madhësisë së ekonomisë, ndërsa GDP-ja për kokë banori ka një korrelacion të ngushtë me trendin në standardet e jetesës me kalimin e kohës dhe norma e rritjes së GDP është ndoshta treguesi më i mirë i vetëm i rritjes ekonomike. Siç shprehet fituesi i çmimit Nobel Paul A. Samuelson dhe ekonomisti William Nordhaus, "GDP dhe pjesa tjetër e llogarive kombëtare të të ardhurave mund të duken të jenë koncepte mizore, ato janë vërtet midis shpikjeve të mëdha të shekullit të njëzet e një", bizneset në vendimmarrjen strategjike. Sipas një studimi që është bërë në vitin 1997 nga Forumi i Ekonomisë Globale,

përmasat e PPB dhe përqindjen e saj të zhvillimit në raport me përmasat e tregut të vendit pritës të investimeve të huaja, është si një faktor përcaktues gjatë marrjes së vendimit mbi lokalizimin e këtyre investimeve.

Në rastin tonë në RMV nga analiza e Ganger për periudhën kohore 2021 -2019 rezulton se GDP nuk ndikon në Investimet e Huaja .

Investimet e huaj ndikon në GDP

Tërheqja e investimeve është prioritet i lartë. Për një gjë të tillë, RMV duhet të punojë fuqishëm në ndërtimin e institucioneve dhe të përmirësojë ambientin biznesor. Për një

ambient të mirë biznesor, para së gjithash, duhen institucione cilësore, kornizë stabile ligjore, strukturë makroekonomike. Duhet institucione që funksionojnë. Cilësia e infrastrukturës, rrugët, rrjetet energjetike janë duke u përmirësuar, por është një proces i ngadaltë. Duhet të shohim më shumë përmirësime që të jenë më tërheqëse për investitorët e huaj.

E gjitha kjo rezulton faktin se të mirat materiale, prodhimet vendore dhe të gjitha institucionet që veprojnë në vend nuk ndikojnë pozitivisht apo negativisht te qytetarët e vendin, por jo domosdoshmërisht mund të themi se e Produkti i Brendshëm Bruto ndikon te investimet e huaja. Investimet janë bazë shumë e fortë për zhvillimin ekonomik të cilit do shteti, e veçmas shtetin tonë siç është Republika e Maqedonisë së Veriut. Investimet e huaja kanë një zhvillim të hovshëm në rritje në vitet në vazhdim. Nxitur nga ndryshimi teknologjik, konkurrenca globale dhe liberalizimi i tregjeve, investimet e huaja luajnë rol kyç në procesin e integritetit global ekonomik. Tërheqja e investimeve të huaja është një nga strategjitë më të rëndësishme për vendet në zhvillim për të rritur formimin e kapitalit në mënyrë që të gjenerojë një shumë më të lartë të GDP-së. Investimet e huaja sjellin kapitalin e nevojshëm, rritin produktivitetin e ekonomisë nëpërmjet transferimit të njohurive dhe teknologjisë, ndikojnë në hapjen e tregjeve të reja për tregti, rritin konkurrencën ekonomike, ndikojnë në reduktimin e deficitit të llogarive korrente, rrisin punësimin dhe mbi të gjitha ndikojnë në mirëqenien e popullsisë.

Nga analiza Ganger kuptojmë se në RMV gjatë periudhës kohore 2012-2019 Investimet e huaja kanë ndikur në GDP e vendit.

Papunësia nuk ndikon në Investimet e Huaja

Papunësia përbën një ndër dukuritë më të rënda ekonomike, ku rritja e treguesit të papunësisë konsiderohet si një simptom i fazës së recensionit ekonomik. Kostot ekonomike të papunësisë shprehen në hendekun e prodhimit ku në situata papunësie merr vlera negative, gjithashtu të papunët janë barrë e rëndë financiare për qeverinë dhe zvoglimin e të ardhurave

personale. Kostot sociale të papunësisë shkaktojnë zhvlerësimin e kapitalit human, sepse shkalla e arsimimit të fituar dhe e aftësisë për punë e humbin vlerën e tyre kur nuk vihen në përdorim për një kohë të gjatë. Nga problemet e shumta ekonomike ndodh të ketë rënie të GDP dhe rritje të papunësisë. Ndryshimet në prodhim maten nëpërmjet llogaritjes së GDP, kurse ndryshimet në papunësi maten nëpërmjet llogaritjes së normës së papunësisë. Marrë në përgjithësi, papunësia nuk ndikon aspak te Investimet e Huaja. Nëse janë mundësitë për Investime të Huaja në një vend, ato investime do jenë të mirëseardhura për shtetin dhe mjaft profitabile për qytetarët e vendit, meqë do rriten shansat për punësim të tyre në firmat apo kompanitë që do jenë investiturë në RMV.

Gjithashtu edhe për variablen sic është papunësia, nga analiza jon konkludojm se për periudh kohore 2012-2019 , norma e papunësis nuk ndikon në Investime e huaja

Investimet e huaja ndikojnë në normën e papunësisë

Edhe pse ky proces duhet trajtuar mirë në këtë punim, nga fakti se a do jenë më të mëdha fitimet që vinë nga investimet e huaja apo nga vetë firmat vendase. Kjo duke marrë parasysh edhe faktin se kompanitë e huaja në investimet e tyre në një shtet konsiderohet se investojnë me teknologji të lartë dhe kjo rrit edhe riskun e ekzistencës dhe konkurrencës së kompanive vendore në këtë aspekt. Një tjetër problem i cili shtrohet është edhe ai se a rrezikohen firmat vendore nga marrja e fuqisë punëtore nga firmat e huaja, nga fakti se ato janë të gatshme të paguajnë shuma më të mëdha të të hyrave mujore nga ajo që janë aktuale në ekonominë vendore. Situata në të cilën gjendet RMV sa i përket fushës së papunësisë, sektoret e ndryshme si bujqësia, ekonomia, kompanitë e ndryshme me kapacitete të mëdha të absorbimit të fuqisë punëtore dhe në këtë drejtim ndikon edhe në uljen e shkallës së papunësisë në vend. Rëndësia e zhvillimit të sektoreve të ndryshme dhe krijimi i vendeve të reja të punës-është garancë e stabilitetit social. Eksporti dhe investimet e jashtme , të cilat do

të sillnin me vete njohuri të reja, teknologji të re dhe do të tërheqin me vete dhe punësime të reja, do të jenë ajo shtylla vendimtare që do të kontribuojë në uljen e shkallës së papunësisë.

Dhe konkluzioni i fundit nga analiza Ganger paraqet se Investimet e huaja kanë ndikim të drejtpërdrejt në normen e papunësisë .

Krahasime marendëse mes investimeve në RMV dhe vendet e tjera në rajon dhe Evropë

Nëse flasim për zhvillimin ekonomik të vendit tone dhe vendeve tjera në rajon dhe Evropë, e gjitha le për të dëshiruar. Përderisa RMV është gati se shteti u fundit në rajon me investime të huaja, në vendet tjera ka rritje graduale. Gjermania, si një nga shtetet më të zhvilluara evropiane, ka rritje të GDP nga Investimet e huaja. Nëse marim parasysh RMV, Investimet e Huaja në Maqedoni në vitin e kaluar shënojnë rënien më të madhe në raport me të gjitha shtetet e tjera të rajonit. Njëherësh, ato shënojnë edhe rënien prej 38 për qind në vitin 2020 në raport me vitet paraprake. Të dhënat, tregojnë se investimet në Maqedoninë e Veriut janë ulur për gati tre herë nga mesatarja e rajonit përgjatë periudhës së pandemisë. Ndërkaq, Qeveria gjermane pret këtë vit një rritje të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) me 1,7 për qind dhe për vitin e ardhshëm një rritje prej 1,5 për qind. Poashtu, pika e fortë tradicionale e ekonomisë gjermane, tregtia e jashtme, do të sjellë nga ana e saj një kontribut ndaj rritjes ekonomike të këtij viti dhe atij të ardhshëm, me një rritje të importeve më të lartë se sa ajo e eksporteve. Më shumë se një milion migrantë kanë mbërritur në Gjermani vitin e kaluar. Kjo do të përkthehet me një rritje të lehtë të papunësisë vitin e ardhshëm, kur këta të kenë marrë statusin e refugjatit dhe të jenë në kërkim të punës.

Situatat e këtilla , problemet ekonomike dhe sociale, papunësia e madhe, politika e luhatur dhe problemet e tjera, janë faktorët dhe ndikuesit negativ për perspektivën e shtetit tonë. Ndaj, e vetmja shpresë e këtij vendi janë respektimi i ligjit, regresi kundër korrupsionit, hapja e vendeve të punës, thithja e investimeve të reja etj.

4.1.3 Koeficienti i determinacionit, aleancës dhe korelacionit midis investimeve dhe GDP për vitet (2009-2019)

Nga programi STATA kemi nxjerr informatat ku do të interpretojmë: (I) koeficientin e determinacionit, (II) koeficientin e aleancës dhe (III) korrelacionin midis investimeve të huaja dhe GDP për periudhën kohore 2009-2019.

Koeficienti i determinacionit – Qëllimi i analizës së regresionit është që të analizojmë sjelljen e variablës së varur Y në rastin tonë (IH). Pas sqarimit të sjelljes së ndryshores së varur është e nevojshme të përcaktojmë madhësinë e kësaj variance.

Varianca e varur Y, ndahet në dy pjesë dhe atë në: $\text{Var}(\hat{Y})$ që paraqet pjesën e shtjelluar nga vija e regresionit dhe $\text{Var}(e)$ paraqet pjesën e pashtjelluar. Në bazë të kësaj paraqitjeje edhe proporcioni i variancës së shtjelluar nga vija e regresionit, ky proporcion njihet si *koeficienti i dererminacionit* ose më ndryshe R^2 (r squared).

$$R^2 = \frac{\text{Var}(\hat{Y})}{\text{Var}(Y)}$$

Vlera e koeficientit të determinacionit (R^2) është nga 0 deri në 1, që nënkupton se vlera maksimale e koeficientit të determinacionit është një, kur të gjitha observimet përputhen plotësisht me vijën e regresionit vlera e koeficientit të determinacionit është një.

Koeficienti i aleancës (kontigjencës) – përcaktohet nga formula e mëposhtme:

$$R^2 = \frac{\text{Var}(\hat{Y})}{\text{Var}(Y)}$$

Koeficienti i aleancës (kontigjencës) merr vlerat prej 0 deri 1. Në modelin tonë ky koeficient përcaktohet si:

Koeficienti i korrelacionit – për dallim nga dy koeficientët e mëparshëm që marrin vetëm vlera pozitive ky koeficient merr vlera nga 0 deri në 1 për pozitive dhe nga -1 deri në 0 për vlera negative. Vlerat -1 ose 1 tregojnë korrelacionin perfekt dhe të fortë ose lidhjen funksionale në mes dy ndryshoreve. Vlerat afër 0 tregojnë korrelacion të dobët. Sa i përket shenjës së koeficientëve, vlerat negative tregojnë raport invers kurse vlerat pozitive tregojnë një raport direkt.

Formula e përcaktimit të koeficientit të korrelacionit duket si në vijim:

$$r = \frac{\sum (X_i - \bar{X})x (Y_i - \bar{Y})}{\sqrt{\sum (X_i - \bar{X})^2x \sum (Y_i - \bar{Y})^2}}$$

Për ndryshoret nën analizë, hyrjet neto të IH-ve (*LNfdini*) dhe rritja reale e PBB për banorë (*LNgdpgpc*), e kalkulojmë koeficientin e korelacionit. Ky koeficient është e dëshirueshme që të jetë më i ulët. Sa më i lartë korrelacioni, aq më e vështirë është që të dallojmë midis efekteve të ndryshores shpjeguese në ndryshoren e varur dhe njëkohësisht edhe regresioni është më pak i saktë.

Nëpërmjet programit statistikor STATA 12 e kalkulojmë koeficientin e korelacionit dhe informacioni i dhënë në STATA duket si në vijim:

(obs=11)

	log_fdi	log_gdp1
log_fdi	1.0000	
log_gdp1	0.0082	1.0000

4.1.4 Devijimi standard i investimeve dhe GDP në periudhën 2009-2019

Devijimi standard paraqet vlerën e rrënjës katrore të madhësisë së variancës dhe devijimi standard i serive të thjeshta gjindet përmes formulës:

$$\sigma = \sqrt{\frac{\sum_{i=1}^n (X_i - \bar{X})^2}{n}}$$

Sa më i vogël që është devijimi standard kjo nënkupton që vlerat individuale të variablës janë të vendosura më afër mesatares aritmetike, siç shihet në grafikun e mëposhtëm:

Për ndryshoret nën analizë, hyrjet neto të IH-ve (*LNfini*) dhe rritja reale e PBB për banor (*LNgdpgpc*), i kalkulojmë përmbledhje të statistikave, ku përfshijmë edhe devijimin standard. Informacioni i dhënë nga STATA 12 duket si në vijim:

```
. summarize log_fdi log_gdp1
```

Variable	Obs	Mean	Std. Dev.	Min	Max
log_fdi	11	19.63484	.6346751	17.92441	20.29053
log_gdp1	11	.9546696	.8423565	-.7811757	1.564084

4.2 Hipotezat

H0 : $b_2 = 0$ Investimet direkte nuk kanë ndikim në GDP e RMV

H1: $b_2 \neq 0$ Investimet direkte kanë ndikim në GDP e RMV

H0: Progresi i tranzicionit është faktor i parëndësishëm në ndikimin e përcaktimit të fluksit të IH-ve në RMV.

H1: Progresi i tranzicionit është faktor i rëndësishëm në ndikimin e përcaktimit të fluksit të IH-ve në RMV.

H0: Zhvillimet në mjedisin e biznesit janë faktorë të parëndësishëm në ndikim në përcaktimin e fluksit të IH-ve në RMV.

H1: Zhvillimet në mjedisin e biznesit janë faktorë të rëndësishëm në ndikim në përcaktimin e fluksit të IH-ve në RMV.

5.0 Përfundimi

I gjithë punimi shkencor ka arritjet e tij profesionale, meqë u përfshinë tema të jashtëzakonshme që janë në të mirën e zhvillimit ekonomik të vendit dhe më gjerë. Investimet e Huaja, hyrjet dhe daljet ekonomike në vendit pritës, regresi, variablet e shumta, zhvillimi ekonomik dhe norma e papunësisë janë çështjet madhore të këtij punimi. Gjatë hulumtimeve të shumta dhe analizave të shumta që ngre kjo temë, duhet të potencojmë se Investimet e Huaja luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Rëndësia e tyre është edhe më e lartë në vendet në tranzicion , ku kapitali i brendshëm është i paaftë për plotësimin e nevojave për investime të ekonomisë në procesin e transformimit. Gjatë pjesës empirike të studimit, e cila është e mbushur me model graviteti, ne arritëm të gjejmë ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv të faktorëve institucional, faktorëve të biznesit dhe faktorëve të tranzicionit në madhësinë e IH-ve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përveç kësaj ky studim shkencor dëshmoi evidencën empirike lidhur me lidhjen shkakësore ndërmjet IH-ve dhe rritjes së PBB-së dhe anasjelltas lidhjen shkakësore ndërmjet PPB-së dhe rritjes së IHD-ve, duke përdorur analizën e serive kohore.

Teza e këtij punimi konsiston në masat që duhet të merren në Republikën e Maqedonisë së Veriut në funksion të rritjes së IHD-ve për ta bërë vendin tonë një vend më tërheqës për investitorët e huaj. Zhvillimi i veprimtarive në publikun e gjerë, komunitetin e biznesit, rëndësia e përfitimeve nga konkurrenca midis aktorëve kyç të tregut. Përfshirja në këto aktivitete edhe e komunitetit ndërkombëtar , me qëllim marrjen e eksperiencave mbi kulturën e konkurrencës.

Përzgjedhja e shtetit tonë si një vend të të pasur zhvillim të madh ekonomik varet nga stabiliteti i politikave ekonomike, nga integriteti i qeverisë (ulja e korrupsionit, taksa të arsyeshme, regrese në sfera të shumta, punësimi i të rinjve në dikasterë të ndryshëm shtetëror dhe privat, zbatimi i projekteve të ndryshme në dobi të vendit etj).

Për të thithur Investime të Huaja duhet të lehtësohet dhe mbështeten investimet direkte në RMV, përmes identifikimit dhe nxitjes së investimeve, duke ofruar shërbime për investitorët ekzistues dhe ata potencialë, të rrisë kokurrueshmërinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve, si dhe teknologjitë që ato përdorin, gjithashtu të nxisë eksportin e mallrave dhe shërbimeve përmes ofrimit të asistencës financiare për kompanitë eksportuese.

Në bazë të FMN dhe OECD investimet reflektojnë qëllimin e marrjës së një interesi afatgjatë nga një entitet rezident i një ekonomie (investitor direkt) në një ndërmarrje që është edhe rezident në një ekonomi tjetër (ndërmarrje direkte investuese). Interesi afatgjatë implikon ekzistencën e një marrëdhënie të gjatë në mes të investitorit direkt dhe ndërmarrjes direkte investuese dhe një shkallë të konsiderushme të ndikimit në menagjmentin e mëvonshëm. Investimet direkte përfshijnë transaksionin fillestar duke krijuar kështu një marrëdhënie mes investitorit, ndërmarrjes dhe të gjithë kapitalit pasues dhe në mes të filialeve qofshin ato të inkorporuara apo jo. Rritja e konsiderueshme e investimeve të huaja në dekadën e fundit dhe përhapja ndërkombëtare, reflektojnë një ngritje në numrin dhe madhësinë e transaksioneve të investimeve të huaja direkte, e gjithashtu një diversifikim në rritjen e ndërmarrjeve për rreth ekonomive dhe sektorëve të ndryshëm industrial. Ndërmarrjet e mëdha multinacionale janë tradicionalisht lojtarët dominant në kufinjet e transaksioneve të investimeve të huaja. Kjo rritje ka konsistuar në një rritje të konsiderushme të pritjeve për ndërmarrjet multinacionale që të marrin pjesë në tregti ndërkombëtare. Në vitet e fundit besohet se edhe ndërmarrjet e mesme dhe të vogla janë duke u përfshirë çdo ditë e më shumë në investime të huaja.

Përgjithsisht investimet e huaja mund të përkufizohen për paraqitjen e blerjen të aktiviteteve fizike jashtë kufijëve të një vendi, si impjante dhe pajisje, nën kontrollin e kompanisë amë. Sikurse mund të jetë krijimi i një dege të re, blerja e aktiveve apo një biznesi të huaj. Në ditët e sotme IH është faktori kryesorë për rritje ekonomike të një vendi si dhe zgjerimin dhe hapjen e vendeve të reja për punësim për të gjitha ato vende të cilat janë në tranzicion një

faktorë tjetër është edhe NVM-ja. Përveç tjerash IH shihet si burimi kryesor i financimeve të jashtme në vendet në zhvillim. Investimet e huaja tëpërveç që rrisin formacionin e kapitalit fiks ato ndihmojnë edhe në bilancin e pagesave. IH ka potencialin për të gjeneruar punësim, rritje të prodhueshmërisë, aftësi transferuese dhe teknologji të re, rritjen e eksporteve, si dhe kontribuon në zhvillim afatgjatë ekonomik të vendeve në zhvillim, kjo sipas pikëpamjes së UNCTAD-it.

IH tradicionalisht është parë si nxitësi kryesor i zhvillimit kombëtar, por ndryshimi i dukshëm strukturor nënkupton që përqëndrimi në punën e lirë si një avantazh konkurrues nuk është më një strategji e zbatueshme për vendet në rajon. (Szent-Iványi,2017), argumentonë se këto vende duhet të lëvizin përtej narrativës së përmirësimit (tërheqjen e hyrjeve të IH me vlera gjithnjë e më të larta të shtuar) dhe përqendrohen në sigurimin e kapjes së vlerës më të madhe. Një mënyrë e mundshme për ta bërë këtë është duke zhvilluar kushtet në të cilat kompanitë kombëtare inovative mund të dalin, të përparojnë dhe përfundimisht të zhvillohen në firmat kryesore të zinxhirëve të vlerave globale.

Referencat:

Benjamin Graham (1949), "The intelligent Investor" – The classic text on value investing

Carkovic, M. V., & Levine, R. (2002). Does foreign direct investment accelerate economic growth? Department of Finance Working Paper.

Caves, Richard E. (1971) "International corporations: The industrial economics of foreign investment."

Chrysoschoydis, George, Carla Millar, and Jeremy Clegg Eds. (1997), "Internationalisation Strategies"

Civici, A., "Transformimi i madh", Tiranë 2014

David Ricardo (1817), "On the Principles of Political Economy and Taxation"

Flamur Bunjaku (2016), Investimet e Huaja Direkte, Aspektet teorike dhe analiza kritike

Fiti T "Konceptet bashkëkohore makro ekonomike dhe politikat ekonomike, Shkup

Fiti T dhe Filipovski V (1999) "Bazat e mikro ekonomisë".

Foreign direct investment in Central and Eastern European countries: a dynamic panel analysis:

[<http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?Doi=10.1.1.165.8323&rep=rep1&type=pdf>]

Frank A. Southard, (1931) "American industry in Europe"

Frederick Arthur McKenzie (1901), "The American Invaders"

Frederick Arthur McKenzie (1902), "The American Invaders"
<https://ideas.repec.org/a/oup/oxecpp/v25y1973i3p289-336.html>

Gresa Krasniqi (2015) Ndikimi i investimeve të huaja direkte në zhvillimin e vendit

Hisnije Haxhimurati (2018) Rëndësia dhe roli i investimeve të huaja në zhvillimin ekonomik të vendit tonë

Ismet Voka, Tiranë 2015, “ Investimet e Huaja Direkte: Roli i tyre në zhvillimin ekonomik të rajonit të Evropës Juglindore”

Jasiqi,H (2012). Raporti i Zhvillimit Njerzor, faqe 145, Zyra Zvicrane

Karl P. Sauvant, Lisa E Sachs (2009), “The effect of treaties on foreign direct investment “- Bilateral Investment Treaties, double taxation treaties and Investment Flows

“Kërkesat e rregullores mbi Standardet e Raportimit Financiar”,

<http://www.luani.net/publikimet-artikujt/items/kerkesat-e-rregulloresmbi-standardet-e-raportimit-financiar.html>

Kule. Dh dhe Haderi. S (2001) , Konsolidimi Makroekonomik: arritje dhe sfida.

“Kontributi i Kontabilitetit dhe Revizionit në Zhvillimin Ekonomik”,
<http://www.luani.net/publikimetartikujt/items/>

Kontributi i kontabilitetit dhe revizionit në zhvillimin ekonomik të Kosovës.
<http://www.luani.net/publikimetartikujt/items/kontributi-i-kontabilitetit-dhe-revizionit-ne-zhvillimin-ekonomik-te-kosoves.html> “Lidhja e analizës së zinxhirit të vlerave me përparësinë konkurruese”,

Lila Dameska, Shkup, 2020 Ekonomia- Për shkollat profesionale drejtimi ekonomik

Mark Douglas (2000), Trading in the zone : Master the market with confidence, dicipline, and Winning attitude

Nathan M. Jensen, Glen Biglase, Quan Li, Edmund Malesky, Pablo M.Pinto, Santiago M. Pinto, Joseph L. Staats (2012) Politics and Foreign Direct Investment

Naqellari. A, (2007) “Makroekonimia “

Schutter.O, Swinnen.J, Wouters.J, Foreign direct investment and human development – The law and economics of international investment agreements

Stephen D. Cohen (2007), “Multinational Corporations and Foreign Direct Investment “ - Avoiding simplicity embracing complexity.

file:///C:/Users/User-2/Downloads/EMPIRICALANALYSISOFFOREIGNDIRECTINVESTMENTANDTHEIRROLEINECONOMICDEVELOPMENTOFTHEREPUBLICOFMACEDONIAIMPORTANCEEFFECTSANDPOLICIESFORTHEIRPROMOTION.pdf

file:///C:/Users/User-2/Downloads/5141-Article%20Text-15159-1-10-20150306.pdf

file:///C:/Users/User-2/Downloads/1307-4448-1-PB.pdf

file:///C:/Users/User-2/Downloads/Macedonia_FDI_Programme_2011%20(1).pdf

<https://databank.worldbank.org/indicator/NY.GDP.MKTP.KD.ZG/1ff4a498/Popular-Indicators#>

<https://unctadstat.unctad.org/CountryProfile/GeneralProfile/en-GB/807/index.html>

<https://unctadstat.unctad.org/wds/ReportFolders/reportFolders.aspx>

https://unctad.org/system/files/official-document/diaepcb2011d3_en.pdf

<https://www.state.gov/reports/2018-investment-climate-statements/macedonia/>

<http://nbstat.nbrm.mk/pxweb/mk/Eksterni%20statistiki/>

http://nbstat.nbrm.mk/pxweb/en/Eksterni%20statistiki/Eksterni%20statistiki_Direktni%20investicii_Direktni%20investicii%20-%20Dvizenja/6_DIRMPoDejnostiGodisniEN.px/

https://unctad.org/system/files/official-document/diaepcb2011d3_en.pdf

<http://www.investinsee.com/country/north-macedonia>

https://www.pwc.com/mk/en/publications/assets/doing_business_guide_macedonia_2016.pdf

<http://fez.gov.mk/wp-content/uploads/2020/11/brosura-invest-komplet-web.pdf>

[.file:///C:/Users/User-2/Downloads/EMPIRICALANALYSISOFFOREIGNDIRECTINVESTMENTANDTHEIRROLEINECONOMICDEVELOPMENTOFTHEREPUBLICOFMACEDONIAIMPORTANCEEFFECTSANDPOLICIESFORTHEIRPROMOTION.pdf](file:///C:/Users/User-2/Downloads/EMPIRICALANALYSISOFFOREIGNDIRECTINVESTMENTANDTHEIRROLEINECONOMICDEVELOPMENTOFTHEREPUBLICOFMACEDONIAIMPORTANCEEFFECTSANDPOLICIESFORTHEIRPROMOTION.pdf)

<https://www.coursehero.com/file/23810630/Investimet-e-Huaja-Direkte/>

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Oltjana-Zoto-Fakulteti-i-Ekonomisë.pdf>

<https://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/01/INVESTIMET-E-HUAJA-DIREKTE-DHE-SHQIP%C3%8BRRIA-R%C3%ABnd%C3%ABsia-dhe-efektet-politikat-p%C3%ABr-nxitjen-e-tyre.pdf>

<https://www.imf.org/en/About>

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2012/09/Oltjana-Zoto-Fakulteti-i-Ekonomisë.pdf>

<http://civicamobilitas.mk/wp-content/uploads/2018/02/1.-Analiza-Benefiti-od-FDI-TIRZ-Makedonija.pdf>

<http://fez.gov.mk/about-us/?lang=MK#1516610898513-f1f141ee-3d22bc63-5cc5>

<https://www.globalethicsnetwork.org/profiles/blogs/the-importance-of-foreign-direct-investment-1>

<https://poseidon01.ssrn.com/delivery.php?ID=988100070082070119008107086018117111029016091027091055028017020026125120091101108126123010021012119029003105086000086025095101111051069047053088117011126107095001011033084077074116104017099121028113001003109010092090019090001069090011094095009013106072&EXT=pdf&INDEX=TRUE>

<https://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/01/INVESTIMET-E-HUAJA-DIREKTE-DHE-SHQIP%C3%8BRIA-R%C3%ABnd%C3%ABsia-dhe-efektet-politikat-p%C3%ABr-nxitjen-e-tyre.pdf>

<https://www.odi.org/publications/594-foreign-direct-investment-development-historical-perspective>

<https://www.oecd.org/daf/inv/investmentstatisticsandanalysis/40193734.pdf>

https://www.academia.edu/11179718/INVESTIMET_E_HUAJA_DIREKTE_N%C3%8B_SHQIP%C3%8BRI_Mikrotez%C3%AB_Cikli_i_par%C3%AB_i_studimeve

<https://prezi.com/naqtpfmjb3sj/roli-i-investimeve-te-huaja-direkte-ne-zhvillimin-ekonomi/>

<http://indianresearchjournals.com/pdf/APJMMR/2012/December/9.pdf>

<http://zmai.mk/wp-content/uploads/pdf/%D0%9F%D0%A3%D0%91%D0%9B%D0%98%D0%9A%D0%90%D0%A6%D0%98%D0%88%D0%90-%D0%90%D0%9B%D0%91%D0%90%D0%9D%D0%A1%D0%9A%D0%98.pdf>

<https://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/01/Investimet-e-huaja-direkte-ne-Shqiperi.pdf>

https://www.researchgate.net/publication/237367817_THE_ATTRACTION_OF_THE_FOREIGN_DIRECT_INVESTMENT_FDI_BY_THE_AFRICAN_COUNTRIEShttps://www.somo.nl/wp-content/uploads/2003/08/BITs-and-a-WTO-Investment-Framework.pdf

<http://www.oecd.org/dev/2698620.pdf>